



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 105

Tiranë – E enjte, 13 korrik 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 47/2023, datë 22.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”..... 11019
Dekret i Presidentit nr. 115, datë 11.7.2023	Për shpallje ligji..... 11020
Ligj nr. 50/2023, datë 22.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar..... 11020
Dekret i Presidentit nr. 116, datë 11.7.2023	Për shpallje ligji..... 11024
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022..... 11024
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022..... 11026
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022..... 11027
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022..... 11029
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022..... 11031
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2022..... 11033
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2022..... 11034

Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2022.....	11036
Rezolutë e Kuvendit datë 6.7.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Radiotelevizionit Shqiptar për vitin 2022.....	11038
Dekret i Presidentit nr. 136, datë 12.7.2023	Për lirin e rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike.....	11039
Vendim i Gjykatë Kushtetuese nr. 35, datë 15.6.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 7.9.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	11039



LIGJ
Nr. 47/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 15/2019, “PËR NXITJEN
E PUNËSIMIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa:

1. Shkronja “ç” e pikës 4 riformulohet si më poshtë:

“ç) familjarët e individëve me aftësi të kufizuar”.

2. Në shkronjën “h” të pikës 4 pas fjalëve “të rinjtë me moshë nën 29 vjeç” shtohen fjalët “që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional”.

3. Pas pikës 20 shtohet pika 21 me këtë përmbajtje:

“21. Kuponi për financimin e formimit profesional” është kuponi që u jepet punëkërkuarëve të papunë, të cilët ndjekin një kurs formimi profesional në subjektet private të formimit profesional”.

Neni 2

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “gj” riformulohet si më poshtë:

“gj) programe sipas skemës së garancisë rinore”.

b) Shkronja “k” riformulohet si më poshtë:

“k) këshillimin për punësim për grupet e veçanta”.

c) Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:

“l) skemën e kuponit për financimin e formimit profesional”.

2. Në pikën 4 fjala “ vendim” zëvendësohet me “vendime”.

Neni 3

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Skema e garancisë rinore

1. Skema e garancisë rinore është pjesë e programeve të punësimit që mbështet të rinjtë, sipas nenit 3, pika 4, shkronja “h”, të këtij ligji.

2. Në kuadrin e skemës së garancisë rinore, të rinjve, sipas nenit 3, pika 4, shkronja “h”, të këtij ligji, u ofrohet një ofertë punësimi/arsimimi të vazhdueshëm/praktika profesionale brenda një periudhe prej katër muajsh nga momenti i regjistrimit në zyrën përkatëse të punësimit.

3. Ministria përgjegjëse për politikën e punësimit dhe formimit profesional është përgjegjëse për hartimin e planit të zbatimit të skemës së garancisë rinore dhe koordinon zhvillimin e kuadrit ligjor të nevojshëm për zbatimin e tij.

4. Programet, sipas skemës së garancisë rinore, dhe procedurat e zbatimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 4

Në pikën 2 të nenit 14 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “d” hiqen fjalët “nxitjes së”.

2. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) “shërben si sekretariat teknik i Fondit Social të Punësimit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 20 ndryshohet si më poshtë:

“2. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1 të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën 100 për qind të pagesë minimale në shkallë vendi për çdo muaj për çdo



person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, që ai duhet të kishte punësuar sipas këtij neni. Kontributi derdhet nga punëdhënësi dhe pasqyrohet në listëpagesën mujore të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të deklaruar në sistemin on-line të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, institucion i cili luan rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e kontributit. Procedurat dhe mënyra e derdhjes së kontributit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 6

Në pikën 3 të nenit 21 në fund të fjalisë së dytë shtohen fjalët “me përjashtim të të ardhurave nga buxheti i shtetit.”.

Neni 7

Pika 3 e nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda datës 31.12.2023 të miratojë aktin nënligjor për procedurat dhe mënyrën e mbledhjes së kontributit për Fondin Social të Punësimit në zbatim të nenit 20, pika 2, të këtij ligji.”.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 22.6.2023.

Shpallur me dekreten nr.115, datë 11.7.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 115, datë 11.7.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 47/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2019, Për nxitjen e punësimit”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**LIGJ
Nr. 50/2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9774, DATË 12.7.2007,
“PËR VLERËSIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E ZHURMËS NË
MJEDIS”, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit termat:

1. “Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”.

2. “Bashki/komunë” dhe “bashkisë/komunës” zëvendësohen përkatësisht me “bashki” dhe “bashkisë”.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2002/49/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 qershor 2002, në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore;

- Deklaratën e Komisionit në Komitetin e Pajtimit mbi Direktivën në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore, e ndryshuar. Numri CELEX 32002L0049, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 189, datë 18.7.2002, f. 12–25.



3. “Organi/t/n i/e qeverisjes vendore”, “organet e qeverisjes vendore”, “njësia e qeverisjes vendore” zëvendësohen përkatësisht me “bashki”, “bashkisë”, “bashkia”, “bashkitë”, “bashkinë”.

Neni 2

Në nenin 3 pas pikës 19 shtohen pikat 20 dhe 21 me këtë përmbajtje:

“20. “Aglomerat” është pjesa e një territori, me numër popullsie më të madhe se 100 000 banorë dhe dendësi popullsie prej më shumë se 3 000 banorësh/km².

21. “Zonë turistike” është zona me vlerë natyrore të peizazhit, historike, kulturore, sportive, shëndetësore dhe pushimi.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1 Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Ministria është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma dhe për përcaktimin e niveleve kufi.

2. Ministria që mbulon shëndetësinë është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit nga ndikimet negative të zhurmës dhe vlerësimin e tyre në shëndetin e njeriut nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, si qendër reference e kërkimit shkencor në fushën e shëndetit publik.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ministria që mbulon rendin dhe sigurinë është organi përgjegjës për ruajtjen e qetësisë publike nga veprimtaritë që lëshojnë zhurmë nga muzika mbi nivelet e lejuara kufi”.

Neni 4

Nenet 6 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8 Bashkia

Bashkia është përgjegjëse për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga

veprimtaritë ekonomike apo sociale që lëshojnë zhurma brenda juridiksionit të saj nëpërmjet:

a) hartimit dhe zbatimit të planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshilli i bashkisë;

b) hartëzimit të zhurmës;

c) shpalljes së zonave të qeta në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur dhe vendosjes së kufizimeve për zhurmën në përputhje me nivelet e lejuara të zhurmave në mjedis dhe kriteret e parashikuara në planin vendor të veprimit;

ç) kontrollit me pajisje të certifikuar për matjen e niveleve të zhurmës, të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë, si dhe marrjen e masave administrative, pezullimin apo mbylljen e veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të veprimtarive që kontrollohen nga organet e tjera të përcaktuara në këtë ligj;

d) bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij ligji dhe akteve të dala në zbatim të tij.”.

Neni 6

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Policia e Shtetit

1. Policia e Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave për ruajtjen e qetësisë publike nga veprimtaritë që lëshojnë zhurmë nga muzika mbi nivelet e lejuara kufi nëpërmjet:

a) kontrollit me pajisje të certifikuar për matjen e niveleve të zhurmës të personave fizikë e juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë nga muzika;

b) kontrollit, matjes, pezullimit apo mbylljes së veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

2. Për mjediset e hapura në zona apo qendra të banuara dhe në zonat turistike, muzika lejohet nga ora 11:00 deri në orën 24:00. Personat fizikë e juridikë respektojnë nivelin kufi të zhurmës, të përcaktuar me akt nënligjor, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Në rast se punonjësi i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit nuk ushtron kontroll në



zbatim të pikës 1 të këtij neni, apo nuk merr masë administrative sipas parashikimeve të këtij ligji, ndaj tij merret masë sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.”.

Neni 7

Në nenin 9 në pikën 2 pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) oraret për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, industriale, sociale, kulturore, argëtuese.”.

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10 Oraret

Llojet e masave mbrojtëse nga zhurma zbatohen në lidhje të ngushtë me oraret kur lëshohet zhurma. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen në këto orare:

1. Dita zgjat 13 orë, prej orës 06:00 deri në orën 19:00;
2. Mbrëmja zgjat 5 orë, prej orës 19:00 deri në orën 24:00;
3. Nata zgjat 6 orë, prej orës 24:00 deri në orën 06:00.”

Neni 9

Në nenin 12 pika 2 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Bashkia, një vit pas hartëzimit të zhurmës dhe përgatitjes së hartave strategjike të zhurmës, harton planin vendor të veprimit, duke mbajtur në konsideratë Planin e Përgjithshëm Vendor, kur:

- a) brenda territorit të tyre kanë nën administrim të paktën një aglomerat;
- b) brenda territorit të tyre ndodhen zona turistike;
- c) gjenden në afërsi të:
 - i. një rruge kryesore rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare në të cilën ka më shumë se 3 milionë lëvizje automjesh në vit;

ii. një hekurudhe kryesore në të cilën ka 30 000 lëvizje trenash në vit;

iii. një aeroporti kryesor civil në të cilin ka më shumë se 50 000 lëvizje në vit, ku lëvizje është një ngritje ose një ulje, duke përjashtuar lëvizjet për qëllime të trajnimit të avionëve të lehtë.”.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“5. Plani i veprimit për menaxhimin e zhurmave miratohet nga këshilli bashkiak dhe rishikohet çdo 5 vjet nga data e miratimit të tij dhe sa herë ndodh një zhvillim madhor që ndikon në gjendjen aktuale të zhurmës.”.

6. Gjatë hartimit të planeve të veprimit për menaxhimin e zhurmës, bashkia konsultohet me publikun sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për konsultimin me publikun në vendimarrjen për mjedisin.

7. Çdo bashki raporton në ministri brenda muajit dhjetor të çdo viti për zbatimin e planit të veprimit.”.

Neni 11

Në nenin 21 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Bashkia publikon hartën strategjike, si dhe planin e veprimit, duke siguruar që informacioni për zhurmën mjedisore dhe efektet e saj të vihet në dispozicion të publikut. Ky informacion duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i aksesueshëm.”.

Neni 12

Kreu V shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 24 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Vetëmonitorimi i zhurmës në mjedis kryhet nga personat fizikë e juridikë, të pajisur me leje mjedisi, të cilëve u përkasin veprimtaritë, instalimet dhe burimet e zhurmës që monitorohen.”.

Neni 14

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25 Matjet

1. Matjet për nivelin e zhurmës kryhen nga:



a) Agjencia Kombëtare e Mjedisit për instalimet e pajisura me leje mjedisi;

b) Policia e Shtetit për veprimtaritë që lëshojnë zhurmë nga muzika mbi nivelet e lejuara kufi;

c) bashkia për veprimtaritë e tjera që lëshojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara kufi.

2. Matjet kryhen në kuadër të kontrolleve dhe në funksion të zgjidhjes së ankesave të organeve shtetërore, të publikut e të personave juridikë e fizikë drejtuar ministrisë, ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë dhe bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet burimi i zhurmës.”.

Neni 15

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, Policia e Shtetit, Policia Bashkiake dhe struktura përgjegjëse për kontrollin e automjeteve në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 16

Neni 30 shfuqizohet.

Neni 17

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga organet e kontrollit, të parashikuara në nenin 29 të ligjit, me dënim kryesor me gjobë si më poshtë:

a) ushtrimi pa leje mjedisore, me specifikim për zhurmat, i veprimtarive që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi të lejuar nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

b) lëshimi i zhurmës nga veprimtaritë mbi nivelin kufi të lejuar, përfshirë edhe muzikën, nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë;

c) prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i pajisjeve dhe i makinerive pa dokumentacionin që tregon nivelin e zhurmës që lëshojnë, nga 10 000 lekë deri në 30 000 lekë;

ç) lëshimi i zhurmës në mjedise të qeta, të shpallura të tilla me akt nënligjor të organeve të qeverisjes qendrore apo të vetëqeverisjes vendore nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë;

d) refuzimi ose moslejimi i grupit të kontrollit për të kryer matjet nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;

dh) fillimi i punës ose i veprimtarisë, pa zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma, që kërkohen për zhvillimin e veprimtarisë që lëshon zhurmë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë;

e) instalimi dhe vënia në punë e makinerive dhe impianteve në mjedise të brendshme apo të jashtme, pa zbatuar masa mbrojtëse, zhurma e të cilave kapërcen nivelin kufi, nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

ë) shfrytëzimi dhe vënia në përdorim e objekteve industriale, që nuk janë pajisur me masat mbrojtëse nga zhurma, nga 30 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, në varësi të dëmit që shkakton zhurma, vendoset edhe dënimi plotësues i mbylljes së përkohshme derisa subjekti të marrë masat e nevojshme për eliminimin e saj, ose mbylljen e përhershme të burimit të zhurmës.

3. Gjoka e vendosur për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përbën titull ekzekutiv dhe paguhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”. Modeli i gjobës përcaktohet nga organi kompetent sipas fushës së përgjegjësisë.”.

Neni 18

Nenet 33 dhe 34 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 33

Dhënia e masës administrative dhe ankimi

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative e ka organi kompetent sipas fushës së përgjegjësisë.

2. Shqyrtimi, dhënia e masës administrative dhe ankimi bëhen në përputhje me parashikimet e ligjit për inspektimin dhe Kodit të Procedurave Administrative.



Neni 34

Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative

Ekzekutimi i masave administrative, në zbatim të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 19

Shfuqizime

Ligji nr. 79/2012 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 25.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Task-Forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare” shfuqizohet.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 22.6.2023.

Shpallur me dekreten nr.116, datë 11.7..2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 116, datë 11.7.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 50/2023. “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

REZOLUTË**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
PËR VITIN 2022****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke mbajtur në vëmendje që realizimi optimal i detyrave të prokurorëve është vështirësuar nga krijimi i vakancave, për shkak të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, zbatimin e rekomandimeve prioritare të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke vlerësuar rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe kujdesin për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;

Duke vlerësuar angazhimin në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, me synim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi;

Duke vlerësuar kontributin e dhënë me opinionet dhe sugjerimet në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij dhe duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të integritetit evropian;

Duke vlerësuar angazhimin për zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO);

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në luftën kundër pastrimit të parave, të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit;

Duke ritheksuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm me organet e drejtësisë



dhe organet ekzekutive ligjzatuese, Kuvendin, organet e tjera homologe vendëse ose të huaja dhe organizatat e asistencës dhe ndihmës në raport me prokurorinë.

Për veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2022 konstaton, se:

Është konsoliduar pavarësia institucionale dhe funksionale e institucionit të prokurorisë, veçanërisht pavarësia e prokurorëve në procesin e hetimit dhe vendimmarrjes në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit.

Është rritur cilësia e hetimeve për veprat penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve, ku prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore në seksionet për të mitur kanë bërë kujdes që ndaj të miturve në konflikt me ligjin të kërkohen masa alternative të dënimit, si: shmangia, ndërmjetësimi, këshillimi për të miturin apo familjen dhe paralajmërimi me shkrim.

Është konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzatuese palë në marrëveshje dy- ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet zyrës së Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht në rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e krimit.

Është përmirësuar bashkërendimi dhe koordinimi me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore në strukturat përkatëse të shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore, me synim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritarë të luftës kundër kriminalitetit.

Mbetet problematikë parësore krijimi i vakancave të përkohshme dhe të përhershme (deri në 42%), për shkak të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve.

Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar përpjekjet për të mundësuar zhvillimin e programit statistikor PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e një sistemi statistikor fleksibël, në kohë reale dhe me të dhëna gjithëpërfshirëse për periudhën tranzitore deri në ngritjen e sistemit të ri (CAMS).

Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të

Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe planit përkatës të veprimit.

Sipas Prokurorit të Përgjithshëm, vlerësimi i rregullimit ligjor aktual vështirëson lidhjen organike efektive mes drejtuesve të prokurorive në prokuroritë e shkallës së parë dhe apeleve me Prokurorinë e Përgjithshme, ndërkohë që angazhimet institucionale që dalin nga rezoluta e Kuvendit, rekomandimet e Këshillit të Ministrave apo raportet e organizmave të tjerë ndërkombëtarë kërkojnë një nivel më të lartë kohezioni institucional.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojë rritja e rolit aktiv të prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.

2. Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje e veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi. Të forcohen kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet, si dhe për hetimin e rasteve të dhunës në familje.

3. Të vijojë puna për vlerësimin e kapaciteteve profesionale, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Të vijojë puna e nisur për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse.

5. Të përditësohet manuali për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadrin e projektit FIIAPP. Të rritet efektiviteti i hetimeve financiare. Të trajnohen policia dhe prokurorët për të përmirësuar teknikat e hetimit financiar. Të rritet efektiviteti i hetimeve për çështjet e pastrimit të parave dhe të krijohet bashkëpunimi institucional ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme dhe zyrës së Prokurorit



të Përgjithshëm për çështjen e monedhave të falsifikuara në vend.

6. Të raportohet mbi gjetje, problematika dhe rekomandime për zbatimin e hartës së re gjyqësore brenda muajit dhjetor.

7. Të punohet për të siguruar aksesin e drejtpërdrejtë në regjistrin elektronik të abonentëve celularë dhe adresat IP nga ana e ofruesve të shërbimit të internetit (jo vetëm në 40 regjistrat kombëtarë) për lehtësimin e hetimeve.

8. Të rritet shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira (agjencitë ligjzbatuese, prokuroria dhe sistemi gjyqësor) për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit.

9. Të rriten kapacitetet institucionale dhe profesionale në prokurori, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional nëpërmjet përdorimit të rrjetit të pikave të kontaktit, të ngritur në zbatim të Konventës së KiE-së për krimin kibernetik për të rritur efektivitetin në luftën kundër krimit kibernetik dhe mashtrimit në internet.

10. Të vijojë forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në lidhje me: i. kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, si dhe ii. për shkelje individuale të magjistratëve.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2022

Në Kuvendin e Shqipërisë është paraqitur raporti “Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022” bazuar në përcaktimet e neneve 104 dhe 105 të ligjit nr. 97/2016. “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në raportin “Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022” janë paraqitur treguesit e punës, gjendja e kriminalitetit sipas juridiksionit përkatës dhe veprimtaria e realizuar në zbatim të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022:

Konsideron si të një rëndësie të veçantë rolin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë.

Vlerëson ngarkesën që Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja kanë mbajtur gjatë vitit 2022, rezultatet pozitive të evidentuara në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe hetimin e një sërë çështjeve të cilat lidhen me korrupsionin.

Vlerëson si inkurajuese rezultatet pozitive në luftën kundër krimit organizuar e shoqëruar me rritjen e bashkëpunimit të homologëve ndërkombëtarë të SPAK-ut.

Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022 konstaton se:

Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë pasur mbështetje aktive me burime buxhetore e njerëzore në trajtimin me paga dhe përfitime të tjera financiare shtesë dhe me instrumente ligjore shtesë në funksion të rritjes së eficiencës së tyre dhe çmon se kjo mbështetje ka rritur pritshmërinë e taksapaguesve shqiptarë për një ritëm më të shpejtë në rezultate më domethënëse në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelet e larta në veçanti, pavarësisht kohës dhe personave të përfshirë në to, si kusht thelbësor për të forcuar më tej besimin e publikut te drejtësia.

Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë kontribuar në plotësimin e elementeve të planit të veprimit ICRG/FATF, duke bërë që Shqipëria të adresojë plotësisht pikën IO.8.



Është rritur vlera e aseteve të konfiskuara dhe numri i çështjeve, të cilat janë përfunduar me vendime dënimi në fushën e pastrimit të parave, si dhe konfiskimet e aseteve kriminale në procesin penal.

Është plotësuar organika me 60 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit edhe nga pikëpamja organizative, duke bërë që struktura e SPAK-ut të vijë drejt konsolidimit, ndërsa plotësimi me prokurorë dhe staf të specializuar është ende në proces.

Ka nisur krijimi i një qasjeje strategjike në komunikimin me publikun për të krijuar dhe siguruar besimin e tij në organet e reja të drejtësisë.

Po vlerësohet në vazhdim krijimi i një sistemi për menaxhimin e çështjeve, i cili do të japë më shumë mundësi për të pasur transparencë dhe pavarësi në trajtimin e çështjeve.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të rrisë përdorimin e teknikave të hetimit dhe numrin e hetimeve proaktive në çështjet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë, përfshirë dhe ish-magjistratë, dhe krimin të organizuar me prioritet çështjet me interes të veçantë publik.

2. Të rrisë numrin e hetimeve financiare dhe pasurore, si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, që rezultojnë nga veprat penale të kryera në kuadrin e korrupsionit dhe krimin të organizuar brenda dhe jashtë vendit.

3. Të forcojë bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të drejtësisë dhe të vlerësojë referimet nga publiku, media dhe shoqëria civile lidhur me praktikën e mundshme korruptive në radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe OPGJ-ve të të gjitha niveleve si kusht për të garantuar përgjegjshmërinë dhe integritetin profesional dhe etik në sistemin e drejtësisë.

4. Të vijojë puna për ngritjen e sistemit të administrimit të çështjeve, ku të vlerësohet dhe përfshirja e krijimit të “track rekordit” për procedimet penale të korrupsionit në nivele të larta, kusht i vendosur edhe nga Komisioni Evropian.

5. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vendeve vakante në SPAK dhe të vijojë me nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat përmirësojnë efikasitetin e tij.

6. Të realizojë ndërtimin i një kornizë strategjike institucionale që të përmbajë: Planin Strategjik të Institucionit, Strategjinë e Komunikimit (procesi të drejtohet nga Koordinatorin për Marrëdhëniet me Mediet); Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe Planin e Trajnimit të punonjësve sipas kategorive, Strategjinë e TIK-ut dhe Sigurisë Kibernetike. Këto të shoqërohen me plane vjetore veprimi.

7. Të hartojë një plan vlerësimi për integritetin, që të përmbajë masa konkrete antikorrupsion, masa mbi etikën dhe sjelljen e punonjësve të SPAK-ut. Plani mund të qëndrojë i veçantë apo të integrohet në planin e veprimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore.

8. Të identifikojë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe të adresohen ato në përputhje me ligjin dhe praktikën e mirëpranuar ndërkombëtare.

9. Të vijojë me nënshkrimin e marrëveshjeve teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe shteteve të tjera që SPAK-u e shikon të nevojshme në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me kompetencat lëndore të SPAK-ut.

10. Të uniformizojë standardet e hetimit dhe ndjekjes penale në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miruar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rëndësinë e funksioneve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore, si dhe pezullimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;



Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në mbikëqyrjen e respektimit të standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë në vendosjen e masave disiplinore dhe procedimeve të tjera sipas përcaktimeve ligjore në funksion të rritjes së efikasitetit funksional për të dyja institucionet;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit të prokurorisë;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat për funksionimin eficient të sistemit të prokurorisë,

Për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022 konstaton:

Hartimin dhe miratimin e akteve të rëndësishme nënligjore, përkatësisht: rregullore “Për standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit”, “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, “Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me medien”, “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

Angazhimin në forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale me Kuvendin, Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Bashkëpunimin e ngushtë me Shkollën e Magjistraturës në funksion të verifikimit të pasurisë dhe figurës së studentëve, që kërkojnë të pranohen në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe kandidatëve që përfundojnë këtë program dhe presin emërimin prokuror.

Kontributin e dhënë në hartimin dhe raportimin për dokumente strategjike kombëtare dhe atyre në funksion të integritetit evropian në bashkëpunim

me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Bashkëpunimin me KPK-në në përgatitjen dhe miratimin e 32 raporteve të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektet magjistratë prokurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Garantimin e aksesit në informacion për publikun në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, si dhe në përditësimin e programit të transparencës dhe publikimin e Regjistratës të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Angazhimin e Komisionit të Buxhetit për përgatitjen dhe hartimin e programit buxhetor afatmesëm të institucionit për periudhën 2023–2025, si dhe shqyrtimin e kërkesave për lejimin e veprimtarive jashtë funksionit të prokurorët.

Angazhimin e Komisionit të Vlerësimit, në: përgatitjen e raporteve për analizimin e aftësive profesionale të prokurorëve të subjekteve të rivlerësimit kalimtar në mbështetje të KPK-së; verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët që u pranuan në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2022–2023; verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për prokurorë të cilët përfundojnë formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin 2022; verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për pozicion drejtuesi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe në drejtim të fillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve.

Angazhimin e Komisionit të Karrierës në emërimin dhe caktimin në detyrë të 22 studentëve të diplomuar në vitin 2022 nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe hartimin e analizës së detajuar mbi propozimin e 40 kandidatëve për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, që rezultoi 15 kandidatë më shumë se 1 vit më parë.

Angazhimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e disa procedurave disiplinore ndaj prokurorëve, si dhe në punimin për hartimin e draftit të rregullores së përbashkët për bashkimin e procedimeve disiplinore mes KLP-së dhe KLGJ-së, në përputhje me nenin 140 të ligjit për statusin.

Angazhimin e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve në marrjen e vendimeve për 8 kërkesa të administruara për mbrojtje nga magjistratë prokurorë.



Angazhimin e Komisionit të Posaçëm për Shqyrtimin e Ankesave Kundër Arkivimit të Hetimit nga ana e ILD-së në trajtimin e 58 ankesave.

Dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimin e ligjeve organike dhe të paketës së reformës në drejtësi brenda kompetencave funksionale të tij.

Zgjedhjen e drejtuesit të SPAK-ut pas përmbylljes së procedurave të ngritjes në detyrë.

Plotësimi i vakancave në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është një proces që duhet përmbyllur me prioritet.

Takimet e përbashkëta mbi baza periodike me Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve ligjore duhen shndërruar në mekanizma të qëndrueshëm dhe efikas.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të përmbyllë plotësimin e vakancave për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe të informojë Kuvendin brenda muajit dhjetor 2023.

2. Të përmbyllë miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë dhe të raportojë në Kuvend për ecurinë brenda muajit dhjetor 2023.

3. Të forcojë bashkëpunimin me Prokurorin e Përgjithshëm në funksion të realizimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve.

4. Të përshpejtojë ritmet e punës në vlerësimin vjetor profesional të prokurorëve dhe të informojë Kuvendin brenda muajit tetor 2023.

5. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor: i. të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkellje, si dhe ii. për ngritjen e një sistemi të ri për menaxhimin e integruar të çështjeve.

6. Të ndjekë dhe të konsiderojë me përparësi angazhimet, detyrimet ligjore dhe funksionale që burojnë nga procesi i zbatimit të hartës gjyqësore.

7. Të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së

sistemit të drejtësisë”, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit në proceset penale.

8. Të adresojë çështjet e konstatuara lidhur me aktivitetin e Këshillit në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke nënvizuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesin për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor;



Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2022, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konstaton:

Miratimin e Planit të ri Strategjik të Këshillit për sistemin gjyqësor në Shqipëri për periudhën 2022–2024.

Miratimin e planit të ri të komunikimit për gjykatat, të shoqëruar me një sërë aktesh, me qëllim rritjen e transparencës.

Plotësimin e Gjykatës së Lartë me 16 anëtarë dhe hapjen e garës për 3 vendet e mbetura vakante përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magistratëve/gjyqtarëve.

Ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit nr. 495, datë 21.7.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”.

Vazhdimin e zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore duke realizuar shtimin e stafit administrativ dhe mbështetjen teknike në sistemin e menaxhimit të çështjeve në gjykatat e apelit, standardizimin dhe përmirësimin e sistemit të llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë përmes miratimit të rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”, si dhe verifikimin dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të 15 punonjësve nga të cilët 5 këshilltarë ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë dhe 10 ndihmës ligjorë në gjykatat e apeleve.

Përcaktimin e numrit të kuotave në Shkollën e Magistraturës për vitin akademik 2022- 2023, plotësimin me 45 kandidatë për magistratë në profilin gjyqtar dhe 10 kandidatë në profilin këshilltar dhe ndihmësligjor për të cilët u krye edhe verifikimi i kriterave formale ligjore, pasurisë dhe figurës.

Vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organet e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve duke depozituar pranë KPK-së 30 raporte të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 150 dosje gjyqësore për 30 subjekte të rivlerësimit kalimtar.

Ushttrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve duke zhvilluar 5 procedimeve disiplinore.

Punën për forcimin e kapaciteteve të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe kontributin

për krijimin e sistemit të ri modern të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, trajtimin e 744 kërkesave duke caktuar 920 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si dhe përfshirë në skemë delegimi 10 gjyqtarë dhe transferuar me pëlqim 9 të tjerë.

Vazhdimin e vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke hartuar dhe miratuar 27 raporte vlerësimi, duke prioritzuar kandidatët të cilët janë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e posaçme dhe gjykatat e apeleve, me qëllim funksionalizimin apo ruajtjen e funksionalitetit të tyre.

Zhvillimin e 114 mbledhjeve plenare, nga të cilat 45 mbledhje për caktim gjyqtarësh me qëllim plotësimin e trupës gjyqësore dhe miratimin e 562 vendimeve.

Marrjen e masave për përmirësimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve (ICMIS dhe ARKIT), duke iu përgjigjur me mbështetje teknike 686 kërkesave të gjykatave nga i gjithë vendi.

Përfundimin me sukses të migrimit të të gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, realizuar në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, si dhe përcaktimin e rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short, marrjen e masave të nevojshme, si dhe testimin i këtij mekanizmi për të mundur realizimin me sukses në praktikë.

Trajtimin e 24 kërkesave në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.

Përditësimin me informacion të faqes zyrtare të internetit me materialet dhe vendimarrjet e Këshillit.

Vijimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm duke zhvilluar një sërë aktivitete, takimesh, konferencash dhe trajnimesh me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile, etj.

Zhvillimin e trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën e Magistraturës, ASPA-n, projektet e asistencës së huaj etj., të 13 punonjësve të institucionit, 103 punonjësve të gjykatave dhe 220 gjyqtarëve.



Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë.

2. Të vijojë me ritme të shpejta procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Të ndjekë ecurinë dhe problematikat në implementimin e hartës së re gjyqësore dhe të informojë Kuvendin e Shqipërisë rreth tyre brenda muajit dhjetor 2023.

4. Të vijojë me hartimin dhe miratimin e kuadrit nënligjor për planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave, si dhe atyre për vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve.

5. Të finalizojë paketën e akteve të nevojshme për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore në zbatim të reformës për nëpunësin civil gjyqësor.

6. Të ndërtojë një strategji konkrete për menaxhimin e çështjeve që presin të shqyrtohen (*backlog*), si dhe të bëjë të mundur standardizimin e normës orientuese për evadimin e çështjeve.

7. Të nxisë Gjykatën e Lartë për njësimin e praktikave gjyqësore, me qëllim vendosjen e standardeve të njëjta në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal, parimit të proporcionalitetit, veçanërisht për zbatimin e masave të sigurimit personal, aplikimin e gjykimeve të posaçme dhe veprave penale të dhunës në familje.

8. Të thellojë bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e kuotave për magjistratët e rinj dhe për trajnimin fillestar të tyre, si dhe për trajnimin e gjyqtarëve në detyrë.

9. Të vijojë me prioritet vlerësimet etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e miratuar.

10. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje.

11. Të kontribuojë nëpërmjet kërkesave të motivuara dhe të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

12. Të raportojë në Kuvend brenda muajit dhjetor 2023 për ecurinë e krijimit të sistemit të ri modern të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

13. Të kontribuojë në adresimin e problematikave të konstatuara në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2022 lidhur me aktivitetin e Këshillit.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale;



Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë;

Bazuar në analizën e të dhënave të referuara në raportin e paraqitur për vitin 2022 nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, konstaton:

Ka ulur numrin e ankesave të patrajtuara të dorëzuara nga organet e mëparshme gjatë periudhës kalimtare.

Ka hartuar dhe miratuar raporte të detajuara vjetore dhe periodike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë lidhur me aktivitetin e institucionit.

Është angazhuar në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale në zbatim të nenit 204, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ka shqyrtuar 1715 ankesa dhe ka marrë 28 vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor për 41 subjekte të hetimit disiplinor.

Ka hartuar dhe miratuar 22 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ për organizimin, funksionimin, menaxhimin dhe kontrollin financiar në institucion.

Ka përfunduar 2 inspektime tematike të iniciuara gjatë vitit 2021 me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.7.2020, të prokurorit të përgjithshëm ‘Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm’”, i ndryshuar, dhe “Respektimi i kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.

Ka bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, prokurorin e përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Ka nënshkruar tri memorandume bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë.

Ka organizuar konferencë ndërkombëtare me homologë të vendeve të BE-së, anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë e të tjerë, si dhe profesionistë të spikatur të së drejtës rreth

temës “Interesi i publikut dhe pavarësia e magistratëve”.

Ka marrë pjesë në një numër konferencash shkencore duke përfutur eksperiencë.

Është angazhuar në ndërveprim me qytetarët nëpërmjet informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes në internet, etj.

Kuvendi i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Përmbylljen brenda vitit 2023 të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare.

2. Fillimin sa më shpejt të vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve në funksion të kryerjes së kontrollit të brendshëm periodik.

3. Vijimin me ritme të shpejta të zhvillimit të sistemit të teknologjisë së informacionit dhe strategjisë së menaxhimit të rasteve në përmbushje të detyrimeve ligjore.

4. Vijimin dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Forcimin e mekanizmave institucionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor.

6. Rritjen e kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet implementimit të eksperiencave dhe përvojave më të mira të institucioneve të huaja me të njëjtën fushë veprimi, me fokus përmirësimin e procesit të punës në trajtimin e ankesave, proceseve hetimore etj.

7. Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe prokurorin e përgjithshëm për përcaktimin e çështjeve për inspektimet tematike me synim rekomandimin për standarde të njëjta në proceset hetimore dhe gjyqësore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 6.7.2023.

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2022****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në mbikëqyrjen e sistemit financiar të vendit dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë në raport me ligjin, si dhe detyrimin për zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e objektivave dhe detyrimeve të saj ligjore;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2022 për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të objektivave strategjike afatmesëm në këto drejtime:

Përmirësimin në hartimin e politikës monetare për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve analizuese, parashikuese dhe kërkimore.

Pasurimin dhe zhvillimin e kuadrit metodologjik dhe rregullator në fushën e stabilitetit financiar dhe politikës makroprudenciale, duke vlerësuar ekspozimet e bankave në prona të paluajtshme me metodologji që vlerësojnë ndërlidhjen dhe rrezikun e përhapjes së krizave në sistemin financiar dhe zbatimin e shtesës makroprudenciale për rrezikun sistematik.

Plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të kërkesave të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, që rregullon veprimtarinë, mbikëqyrjen dhe administrimin e rreziqeve të subjekteve të ligjit, përfshirë edhe rregulloren për administrimin e rreziqeve dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike, si dhe përafrimin e këtij kuadri me rregulloret e BE-së dhe të Autoritetit Bankar Europian. Zhvillimet e rëndësishme infrastrukturore dhe përmirësimet rregullatore të mësipërme kanë lejuar ofrimin e instrumenteve të reja të pagesave elektronike dhe krijimin e institucioneve të reja që ofrojnë ato, kanë ulur kostot e pagesave ndërbankare, si dhe kanë nxitur përfshirjen financiare të popullatës.

Forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës dhe plotësimit të kuadrit rregullator të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të lënë nga

Komiteti Moneyval nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në rregulloren përkatëse për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre për sa u takon kërkesave për pastërtinë e figurës së anëtarëve themelues të këtyre subjekteve. Gjithashtu, Banka ka vijuar me inspektimet veçanërisht për çështjet e financimit të terrorizmit duke realizuar për vitin 2022 një numër total prej 82 inspektimesh, të fokusuara në 5 banka, 5 subjekte financiare jobanka, 2 shoqëri kursim-krediti dhe 70 zyra të këmbimit valutor.

Përmirësimin e kuadrit rregullator në fushën e mbikëqyrjes, duke e përafruar më tej tre rregullore me *acquis*-in e BE-së, parimet e Komitetit të Bazelit dhe praktikën më të mira të mbikëqyrjes bankare me vëmendje të veçantë monitorimin e ecurisë së portofolit të kredisë dhe të rrezikut kibernetik, si dhe përfshirjen e rreziqeve klimaterike në proceset e mbikëqyrjes së institucioneve të licencuara.

Monitorimin për sa i takon rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit atij operacional etj., nëpërmjet realizimit të 13 ekzaminimeve në vend, nga të cilat 8 ekzaminime në banka, 2 në subjekte financiare jobanka, 2 në shoqëritë e kursim-kredit dhe 1 subjekt financiar jobankë.

Monitorimin e procesit të administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe rritjes së nivelit të automatizimit të tij për të gjitha bankat që operojnë në tregun vendas, përfshirë edhe bankat josistemike për të vlerësuar nëse disponojnë kapacitete të mjaftueshme financiare për të përthithur humbjet në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Sigurimin e funksionimit maksimal të sistemeve të pagesave, duke kryer vlerësimin e të dy sistemeve që operon Banka e Shqipërisë (AIPS dhe AECH) sipas parimeve mbikëqyrëse të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre nëpërmjet fillimit të funksionimit të sistemit AIPS euro, i cili siguron kryerjen e pagesave ndërkombëtare në euro brenda vendit për klientët e bankave, duke shmangur bankat korrespondente.

Rritjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave nxitur nga masat e Bankës së Shqipërisë dhe politikën e bankave për promovimin e tyre, ku rezultoi një rritje e vazhdueshme e pagesave me karta, pagesave me para elektronike, si dhe pagesave *home banking*. Numri i pagesave në total për vitin 2022 u rrit me



18.1%, duke kapur nivelin prej rreth 33.7 milionë pagesash, ndërsa vlera në total e pagesave rezultoi 5,767 miliardë lekë, me një rritje prej 9.0% nga një vit më parë. Gjithashtu, rritje ka pasur dhe për sa i takon numrit të institucioneve të parasë elektronike, ku për vitin 2022 kanë operuar 9 institucione të tilla nga 7 që ishin në vitin 2021, të cilat kanë kryer një volum prej 10.2 milionë pagesash me vlerë 45.4 miliardë lekësh.

Akomodimin e kërkesës për *cash* në ekonomi, si dhe përfundimin e emetimit të plotë të serisë së re të kartëmonedhave. Në fund të vitit 2022 rezultuan rreth 161 milionë copë kartëmonedha në qarkullim, me vlerë 394.7 miliardë lekë, me një rritje prej 4.9% në krahasim me vitin 2021.

Harmonizimin e statistikave me *acquis communitaire*, ku veçohen hartimi i statistikave përfshirë bilancet e sektorit të subjekteve të tjera financiare jo banka dhe raportimi i llogarive financiare sipas standardeve pranë Eurostat.

Intensifikimin e punës kërkimore në mbështetje të vendimmarrjes dhe rritjes së transparencës, me fokus analizat e skenarëve të ndryshëm që vlerësojnë aftësinë e ekonomisë shqiptare në kushtet e krizave dhe sfidat që paraqesin ndryshimet klimatike në stabilitetin bankar.

Edukimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me publikun përmes botimeve të rregullta për politikën monetare, stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen bankare, si dhe përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë në lidhje me veprimtarinë e Bankës.

Kuvendi kërkon që Banka e Shqipërisë për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:

Të monitorojë në vazhdimësi të gjitha zhvillimet e brendshme dhe të jashtme të ekonomisë, si dhe të kujdeset të formulojë një politikë monetare, e cila të mundësojë kthimin e inflacionit në objektiv, me sa më pak kosto mbi rritjen afatgjatë të ekonomisë.

Të analizojë me prioritet zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme, si dhe të monitorojë me kujdes ekspozimin e sektorit bankar ndaj këtij tregu, duke përmirësuar kuadrin e monitorimit dhe administrimit të rreziqeve në këtë drejtim, si dhe zhvillimin e instrumenteve të nevojshme për të adresuar çdo kontigjencë të mundshme.

Të standardizohet dhe përmirësohet, në linjë me praktikën më të mira evropiane, procesi i administrimit të kredive me probleme, i cili, siç theksohet edhe nga institucionet ndërkombëtare,

është ekspozuar ndaj zhvillimeve të pafavorshme ekonomike ndërkombëtare.

Të fokusohet në zbatimin e mësimave të nxjerra nga përballja me pandeminë, analizën e implikimeve të inovacionit të tregjeve dhe produkteve financiare, si dhe monitorimin e rreziqeve klimatike në mjedisin ekonomik e financiar.

Të përmirësojë proceset e zbatimit të politikës makroprudenciale me fokus pasurimin e instrumenteve makroprudenciale, që synojnë rreziqet sistemike strukturore dhe plotësimin e kuadrit rregullator mbi kërkesat që duhet të plotësojë sektori bankar për sigurimin e një mbrojtje të përshtatshme kibernetike.

Të fokusohet në zbatimin e risive rregullative dhe infrastrukturore të ndërmarra të sistemit të pagesave, siç janë nxitja e përdorimit të skemës së debitimit direkt nga publiku i gjerë dhe mbështetja e pjesëmarrjes së aktorëve të rinj.

Të bashkërendojë përpjekjet për nxitjen e përdorimit të instrumenteve sa më efikase dhe me kosto të ulët me qëllimin reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonominë shqiptare.

Të rrisë bashkëpunimin me bankat, ACESK-un dhe palët e treta mbështetëse për sistemet e sigurisë dhe informacionit, duke maksimizuar sinergjitë mbi rritjen e kontroleve të sigurisë kibernetike, indikatorëve të komprometimit etj.

Të intensifikojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të tregut financiar, duke u përqendruar në kryerjen e ekzaminimeve të përbashkëta në subjektet e mbikëqyrura.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e



shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë për detyrë realizimin e reformës në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2022 në drejtim të:

Mbikëqyrjes tematike apo të përgjithshme për institucione të pavarura, njësi të qeverisjes vendore dhe institucioneve të administratës shtetërore;

Fillimit të mbikëqyrjes së orientuar nëpërmjet vendimit nr. 129, datë 27.10.2022, për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në të gjitha institucionet e administratës shtetërore;

Monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore që u realizuan në 6 bashkitë e vendit në vitin 2022;

Mbikëqyrjes së orientuar nëpërmjet monitorimit online dhe në subjekt në lidhje me rekrutimet e realizuara nga DAP-i;

Trajtimit të ankesave nga Komisioneri, të ardhura nga kandidatë apo nëpunës që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit të organizuara nga njësia përgjegjëse (DAP) për vitin 2022 për të cilat pretendohet se janë kryer apo lejuar parregullsi gjatë zhvillimit të tyre;

Realizimit të mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me monitorimin e procesit të lirim të shërbimi civil të punonjësve që kanë plotësuar moshën për të dalë në pension të plotë pleqërie;

Vijimit të procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit pas përfundimit të afatit të paralajmërimit si për subjektet e mbikëqyrura, ashtu edhe për inspektimet individuale të lidhura me trajtimin e ankesave të nëpunësve civilë;

Pjesëmarrjes së Komisionerit në procese gjyqësore në të gjitha rastet kur është thirrur nga gjykata si palë në pozita të ndryshme procedurale;

Fillimit të mbikëqyrjes së orientuar për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në procedurat e konkurrimeve të zhvilluara nga DAP-i gjatë vitit 2022 nëpërmjet vendimit nr. 58, datë 28.4.2022, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në konkurrimet e planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2022, me procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)”;

Bashkëpunimit me DAP-in për hartimin e propozimeve për ndryshimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kuadër të funksionalizimit të Regjistratës Qendrore të Personelit dhe platformës së bashkëpunimit “administrata.al”; në lidhje me procesin e trajnimit të nëpunësve civilë, të cilët kanë si kërkesë specifike të pozicionit të tyre të punës, edukimin arsimor në fushën juridike; në lidhje me trajnimin e nëpunësve civilë të administratës vendore dhe institucioneve të pavarura në drejtim të strukturimit të shërbimit civil në veçanti dhe të institucionit në tërësi;

Bashkëpunimit me ASPA-n për trajnimin e Njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të pushtetit vendor për të siguruar unifikimin e praktikave në përputhje me detyrat dhe udhëzimet e Komisionerit;

Bashkëpunimit me institucione që luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shërbimit civil, për shkak të kompetencave specifike, si: këshilli bashkiak, prefekti i qarkut, si dhe Ministria e Brendshme në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022;

Bashkëpunimit në kuadër të zbatimit të parimit të llogaridhënies para Kuvendit të Shqipërisë, ashtu edhe të realizimit të detyrave të shtetit shqiptar lidhur me anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian;

Nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit më datë 3.11.2022 me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;



Bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e administratës publike.

Kuvendi kërkon që Komisioneri për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë puna në drejtim të evidentimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqësues, me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të tyre.

2. Të përfshihet në një pikë të veçantë në programin e mbikëqyrjes verifikimi i ecursisë së procesit të popullimit me të dhëna të sistemeve: Regjistri Qendror i Personelit (HRMIS) dhe Platforma e Bashkëpunimit administrata.al, duke nxjerrë përgjegjësinë në rast mosveprimi, si edhe duke lënë detyra konkrete për të përmirësuar situatën, si për institucionet e mbikëqyrura ashtu edhe për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Departamentin e Administratës Publike (DAP).

3. Të intensifikojë punën lidhur me procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit pas përfundimit të afatit të paralajmërimit si për mbikëqyrjet në subjekt, ashtu edhe për inspektimet e lidhura me verifikimin e ligjshmërisë së akteve individuale administrative, të nxjerra nga nëpunës që kanë detyra specifike gjatë administrimit të shërbimit civil, me qëllim rritjen e numrit të vendimeve të verifikuara.

4. Në bashkëpunim me institucionet që punësojnë nëpunës civilë, të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2023 dhe t'i vihet në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë duke mbajtur në monitorim ato njësi të vetëqeverisjes vendore, të cilat pas zgjedhjeve të vitit 2023 do të kenë një kryetar/e të ri/re.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke theksuar faktin se gjatë vitit 2022, bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive u plotësua me të gjithë anëtarët e tij, duke zgjidhur një ngërç që ishte krijuar për një kohë relativisht të gjatë në punën e AMA-s;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar janë një hap i rëndësishëm përpara në drejtim të përafrimit me direktivën e BE-së, veçanërisht në drejtim të rritjes së transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre, si dhe sigurimin e aksesit të “personave me aftësi të kufizuar”;

Duke konsideruar që një ndër objektivat kryesorë të AMA-s është që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimet fetare, kulturën dhe moralin e qytetarëve, ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias;

Vlerëson:

Bashkëpunimin e AMA-s me institucionet e tjera në hartimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshime të cilat bëjnë të mundur përafrimin e pjesshëm me Direktivën (BE) 2018/1808 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 nëntor 2018, si dhe ndër të tjera edhe rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike.

Punën e bërë nga AMA për finalizimin me sukses të procesit të koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), si dhe mundësimin të operimit të rrjetit të



shtatë në Shqipëri, duke përmbushur objektivin për trajtim dhe qasje të barabartë për të 7 operatorët audiovizivë kombëtarë në operim (publik/privat).

Punën e bërë nga AMA për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme lokale gjatë muajit mars 2022 në disa bashki në vend.

Punën e bërë nga AMA gjatë vitit 2022 në organizimin e konferencave dhe tryezave të ndryshme konsultuese për rishikimin e Kodit të Transmetimit me grupet e interesit, përfaqësues të autoriteteve homologe, ekspertë të botës akademike dhe medias, përfaqësues nga OJF-të.

Bashkëpunimin e AMA-s me AKEP-in në inspektimet e kryera në lidhje me fenomenin e piraterisë, si dhe punën e bërë në lidhje me fenomenin tjetër që po haset në këtë periudhë, atë të shtimit të numrit të operatorëve piratë, që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme, që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s.

Përpjekjet e AMA-s për bashkërendimin e punës midis institucioneve për gjetjen e zgjidhjeve më të mira teknike lidhur me problematikën e heqjes nga shtyllat elektrike të kabllove të operatorëve kabllore.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 rekomandon:

1. Në zbatim të ndryshimeve ligjore të miratuara në lidhje me transparencën e pronësisë së mediave, AMA të marrë të gjitha masat që Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) të bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Të ndjekë me rigorozitet zbatimin nga ana e Ofruesve të Shërbimeve përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligjin e ri të miratuar, veçanërisht ato të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre, sigurimi i aksesit të “personave me aftësi të kufizuar” etj.

3. AMA të marrë masat e nevojshme për caktimin e një pike kontakti në faqen e saj zyrtare, lehtësisht të arritshme nga personat me aftësi të kufizuar, për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me aksesin në shërbimet e ofruara nga OSHMA-të për personat me aftësi të kufizuar.

4. AMA duhet të jetë më aktive dhe reaguese në rastet e kanosjeve dhe sulmeve kundër gazetarëve, si dhe në rastet e kërcënimeve ndaj medias ngado që ato vijnë.

5. AMA të luajë një rol aktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e grupit ndërinstitucional të punës për lirimin e brezit digjital dividend dy (DD2); lirimi i brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

6. Pas përfundimit të procesit të këshillimit publik, AMA të shqyrtojë me seriozitet komentet dhe sugjerimet nga të gjithë aktorët dhe faktorët për të bërë të mundur që Kodi i ri i Transmetimit të jetë sa më në koherencë me sfidat dhe zhvillimet në fushën e medias dhe më tej të vijojë me miratimin e tij.

7. Në kushtet kur problemi i mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave prej vitesh nuk po merr zgjidhje, AMA në bashkëpunim me OSHMA-të të rrisin përpjekjet për një zgjidhje alternative të pranueshme dhe më pak të kushtueshme për periudhën kalimtare, siç mund të jetë titrimi.

8. AMA, duke pasur parasysh rëndësinë që ka në funksion të interesit publik vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike të një vendi, pas finalizimit të liritimit të brezit DD2, të iniciojë menjëherë procesin e rishikimit të tarifave të mbështetjes duke kërkuar nga operatori publik rishikimin e tyre, në mënyrë që këto tarifa të jenë proporcionale dhe jodiskriminuese.

9. AMA të luajë një rol proaktiv në propozimin e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e legjislacionit për reklamat publike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

10. AMA, gjatë procesit të hartimit apo ndryshimit të kuadrit nënligjor, të ketë në vëmendje mbështetjen dhe lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve në fushën audio/audiovizive, si dhe rritjen e transparencës së rregullatorit.

11. AMA t'i kushtojë vëmendje monitorimit të portaleve dhe faqeve online që hapen nga media të ndryshme audiovizive; fenomenin e denigrimit që iu



bëjnë personave të ndryshëm këto portale apo media është shumë shqetësues.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 6.7.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të saj, realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe pakicat kombëtare;

Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, ofrimin e një game të gjerë projektesh në interes të grupeve të ndryshme sociale, rritjen e audiencës dhe shtrirjen sa më të madhe në vend;

Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare, duke bërë të mundur rritjen e besimit të publikut;

Vlerëson veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar gjatë vitit 2022 në drejtim të:

Prodhimtarisë së lartë televizive, si: emisione, dokumentarë, reportazhe, prodhime origjinale dhe shumë bashkëpunime si partner mediatik i një sërë ngjarjesh artistike;

Rikonceptimit të imazhit të RTSH-së, rinovimit të studiove dhe ndryshimit të skenografive që ofrojnë një imazh dhe cilësi më të mirë për të qenë sa më konkurrues në tregun mediatik;

Pasurimit të kanalit “RTSH Shkollë” krahas kurrikulës mësimore edhe me emisione argëtuese dhe edukative, me qëllim zgjimin e kuriozitetit dhe mbajtjen e audiencës të angazhuar;

Ridimensionimit të programit të radios sipas modelit që imponon aktualiteti, në mënyrë që ajo të ofrojë dobishmëri dhe strategji për përballimin e sfidave.

Digjitalizimit të materialeve audio të fondit të Radio Tiranës.

Rritjes së veprimtarisë së Orkestrës Simfonike të RTSH-së me koncerte të programuara në bashkëpunim me institucione të tjera, si: TKOB apo Orkestra Simfonike e Kosovës.

Kuvendi kërkon që Radiotelevizioni Shqiptar për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:

1. KDRTSH-ja të informojë sa më parë Kuvendin në lidhje me prodhimet e porositura gjatë vitit 2022 nga fondi i prodhimit të pavarur.

2. Të bëhet transparente veprimtaria e KDRTSH-së në faqen zyrtare online duke u publikuar të gjitha vendimet e marra të shoqëruara edhe me relacionet përkatëse, procesverbalet e mbledhjeve dhe mënyrën e votimit.

3. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Bordit të Administrimit, duke publikuar aktivitetin e këtij bordi dhe të gjitha vendimet e marra dhe aktet e miratuara.

4. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, si dhe të publikohen të gjitha vendimet e tij.

5. Të angazhohet në realizimin e më shumë emisioneve, programeve argëtuese, kulturore e edukative, prodhime të RTSH-së për të rinjtë, konkretisht grup-moshave 10–14 vjeç, si dhe 15 deri në 18 vjeç, me fokus të veçantë informimin dhe edukimin për fenomenin e bullizmit në këto grup-mosha.

6. T’u dedikohet një pjesë e fondit të prodhimeve të pavarura emisioneve për fëmijë, me qëllim informimin dhe edukimin për mirëqenien shëndetësore psikofizike të tyre.

7. Të angazhohet në pasurimin e kanalit “RTSH Shkollë” me emisione kulturore e rubrika argëtuese, veçanërisht në fundjava, si dhe me një programim më të përshtatshëm të transmetimeve në ditët e pushimeve shkollore, duke siguruar gjithëpërfshirje gjeografike të shkollave të territorit dhe duke pasqyruar aktivitetet artistike të këtyre shkollave.

8. Të angazhohet për transmetimin e programeve edukative, të parashikuara në dispozitat e ligjeve specifike për mbrojtjen e shëndetit, siç është edhe ligji nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar”.



9. Të publikojë në faqe shpenzimet e festivaleve, si dhe shpenzimet për prodhimet e pavarura audiovizive, në funksion të transparencës mbi përdorimin e fondeve publike.

10. Në “RTSH Kuvend” të përfshihen edhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

11. Në kuadër të transparencës, të publikohet në faqen zyrtare struktura organizative dhe organika e RTSH-së, të reflektohen vakancat e krijuara dhe të jetë transparente e gjithë procedura e rekrutimit.

12. KDRTSH-ja të investohet në hartimin e planit strategjik të institucionit për të siguruar qëndrueshmëri dhe vizion në drejtimin e transmetuesit publik.

13. Të angazhohet në arkëtimin e detyrimeve financiare duke synuar uljen e vlerës debitoare ndaj RTSH-së.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 6.7.2023.

DEKRET
Nr. 136, datë 12.7.2023

**PËR LIRIMIN E REKTORIT TË
AKADEMISË SË STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 39, pikat 8 dhe 10, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Luan Përzhita lirohet nga detyra e rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 35, datë 15.6.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 11.4.2023, 26.4.2023, 2.5.2023 dhe 29.5.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen me nr. 6 (Nj.) 2022, që u përket:

KËRKUES: JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Dhurata Çupi dhe Gazmend Bardhi, si dhe avokat Marash Logu.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar me autorizim nga Elira Kokona dhe Avokatja e Shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 7.9.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 18, 81, 116 dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë (*kërkesë*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimin me shkrim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi mungesën e mendimit me shkrim të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarjet “iii” dhe “iv”, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (*ligji nr. 107/2014*), ka miratuar vendimin nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi” (*VKM nr. 589/2022*), i cili ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 122, datë 12.9.2022.

2. Ligji nr. 107/2014 ka për qëllim, ndër të tjera, të vlerësojë dhe të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në nivel kombëtar e vendor, të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale, si dhe të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit (*neni 1*). Objekti i tij është përcaktimi i parimeve bazë, përgjegjësi dhe rregullave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Republikën e Shqipërisë (*neni 2*).

3. Neni 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarjet “iii” dhe “iv”, i këtij ligji ka këtë përmbajtje: “*Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbejnë veprën penale, përbejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë: ... e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime*

fitimi dhe me: ...iii. konfiskim për interes publik apo strehim social të punimeve të kryera pa leje kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor nëse tejkalon masën 2% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë, në të cilat për shkak të qëndrueshmërisë së objektit është e pamundur prishja e saj; iv. konfiskim për interes publik me propozim të IKMT-së ose IMT-së dhe vendim të KKT-së të të gjithë objektit kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor nëse tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë, kur ndërtesa është e qëndrueshme dhe është në përputhje me planet e përgjithshme, si edhe me planet e detajuara vendore. Rregullat dhe procedurat përkatëse për konfiskimin për interes publik miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

4. Në zbatim të këtij delegimi, VKM-ja nr. 589/2022 ka përcaktuar rregullat dhe procedurat që ndiqen për konfiskimin e objekteve të ndërtuara pa leje ose në tejkallim të saj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 107/2014, ku përfshihen organet kompetente, fillimi i procedurës dhe dokumentacioni përkatës, marrja e vendimit për konfiskim, zbatimi i tij, si dhe e drejta e parablerjes së objektit.

5. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe VKM-së nr. 589/2022, ka nxjerrë udhëzimin nr. 27, datë 23.9.2022 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 7.9.2022 ‘Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi’” (*udhëzimi nr. 27/2022*).

6. Në datën 14.10.2022 një grup prej 28 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), në cilësinë e subjektit kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e VKM-së nr. 589/2022 si të papajtueshme me Kushtetutën, duke pretenduar se ajo bie në kundërshtim me nenet 4, 7, 18, 41, 42, 81, 116 dhe 118 të saj.

7. Në datën 30.11.2022 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike, duke përcaktuar edhe subjektet e interesuara që do të thirreshin në këtë gjykim. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, si dhe të drejtat kushtetuese të përfshira në këtë çështje, Kolegji ka vlerësuar, gjithashtu, që të marrë



mendim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Prokuroria e Përgjithshme.

8. Në seancën plenare të datës 11.4.2023, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të parregullsisë së aktit të përfaqësimit dhe moslegjitimitit *ratione personae* të kërkuesit. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këto kërkesa paraprake, vendosi shtyrjen e seancës në datën 26.4.2023, për t'i dhënë mundësinë kërkuesit të paraqiste prapësime me shkrim në lidhje me këto kërkesa paraprake.

9. Për sa i përket pavlefshmërisë së aktit të përfaqësimit të kërkuesit, Gjykata, me vendimin e ndërmjetëm të datës 26.4.2023, vendosi se subjekti kushtetues, një e pesta e deputetëve, nuk mund të njësohet me subjektin parlamentar të grupit të deputetëve. Subjekti kushtetues i përcaktuar nga norma kushtetuese, neni 134, pika 1, shkronja “c”, mund të formohet nga deputetë të ndryshëm të Kuvendit, që i përkasin një ose shumë grupeve parlamentare që organizohen brenda organit ligjvënës. Në këtë kuptim, edhe nëse shfaqet rasti që deputetët që kanë vënë në lëvizje gjykimin kushtetues i përkasin vetëm një grupimi të tillë, kjo nuk i jep të drejta dhe tagra drejtuesit të grupit parlamentar të përcaktojë përfaqësimin e subjektit kushtetues në Gjykatë. Këta tagra i përkasin vetëm subjektit kushtetues, vullneti i të cilit manifestohet përmes shprehjes së vullnetit të deputetëve që kanë formësuar këtë subjekt në çdo rast.

10. Në këtë drejtim, Gjykata konstatoi se edhe pse deputetët e subjektit kushtetues nuk kanë asnjë pengesë dhe mund të zgjedhin të marrin pjesë personalisht në procesin kushtetues, neni 24 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se kur objekt kërkesë është një ligj ose akt normativ, kërkuesi përfaqësohet në gjykim me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar. Në zbatim të këtij rregullimi ligjor, për t'u legjitimuar një avokat ose përfaqësues ligjor i specializuar, është e nevojshme pasja e një akti nga subjekti kushtetues, që përfaqëson vullnetin e deputetëve të këtij subjekti për përfaqësimin e detyrueshëm që kërkon ligji².

11. Në seancën e datës 2.5.2023, pas afatit kohor që u la në dispozicion nga Gjykata për të paraqitur dokumentacionin e duhur në lidhje me aktin e përfaqësimit, kërkuesi depozitoi autorizimin e 29 deputetëve për përfaqësuesit e tij në gjykim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se akti i përfaqësimit i paraqitur nga kërkuesi, një e pesta e deputetëve të Kuvendit, plotëson kërkesat formale të përfaqësimit të tij.

12. Për sa i takon kërkesës tjetër paraprake të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka të bëjë me legjitimitimin formal të kërkuesit, Gjykata do ta analizojë atë në vijim së bashku me kriteret e tjera të legjitimitimit të tij (*shih paragrafët 24–25 të vendimit*).

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka parashtruar si vijon:

13.1 Për legjitimitimin

Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të Gjykatës, pasi në aspektin formal subjekti kushtetues, jo më pak se një pesta e deputetëve, formësohet në momentin e paraqitjes së kërkesës. Në këtë moment të gjithë nënshkruesit e kërkesës kanë qenë deputetë dhe dy prej tyre kanë hequr dorë nga mandati i deputetit një muaj më pas. Vetë Kolegji i Gjykatës ka verifikuar nëse kërkesa përmbushte kushtet formale dhe materiale për të kaluar në seancë plenare, në përputhje me nenet 27, 31 dhe 31/a të ligjit nr. 8577/2000. Ky ligj nuk parashikon verifikimin e legjitimitimit të kërkuesit në asnjë fazë tjetër të gjykimit. Gjithsesi, edhe dy deputetët e tjerë që kanë zëvendësuar deputetët që kanë hequr dorë nga mandati, si dhe një deputete tjetër, kanë shprehur vullnetin e tyre për t'u bashkuar këtij gjykimi kushtetues. Po kështu, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për një interes publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi VKM-ja nr. 589/2022 është miratuar në datën 7.9.2022 dhe ka hyrë në

² Gjyqtarja Marsida Xhaferllari votoi kundër këtij qëndrimi, me arsyetimin se praktika e deritanishme e Gjykatës, që ka pranuar aktet e përfaqësimit të lëshuara nga drejtuesit e grupeve parlamentare, nuk mund të ndryshohet për çështje që janë në proces dhe se rregullat e përfaqësimit

të grupeve parlamentare duhet të respektojnë edhe parimin e autonomisë në aspektin e vetërregullimit.



fuqi në datën 12.9.2022, me botimin e saj në Fletoren Zyrtare, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 14.10.2022, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

13.2 *Për themelin e kërkesës VKM-ja nr. 589/2022 cenon:*

13.2.1 *Parimin e shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave*, pasi akti noterial barazohet me kontratën e premtim shitjes, që përbën shprehje të interesit nga ana e zhvilluesit për ndryshimin e lejes së ndërtimit, duke ligjëruar në këtë mënyrë veprimtarinë e ndërtimit të paligjshëm. Ligji nr. 107/2014 ka parashikuar në mënyrë taksative kushtet për ndryshimin e lejes së ndërtimit duke referuar në VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (VKM nr. 408/2015) të ndryshuar me VKM-në nr. 457/2022 dhe kërkesa për këtë ndryshim nuk mund të bëhet në raste të tjera. VKM-ja nr. 589/2022 e konsideron aktin noterial si kërkesë për ndryshimin e lejes së ndërtimit, duke cenuar kështu parimin e hierarkisë së normave të parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës. Gjithashtu, VKM-ja bie në kundërshtim edhe me nenin 199/a të Kodit Penal (KP), pasi objekti me ndryshimin e lejes së ndërtimit do të konsiderohet në kushtet e ndërtimit të ligjshëm, për rrjedhojë do të përjashtohet nga objekti i veprës penale.

13.2.2 *Rezervën ligjore*, të parashikuar në nenin 118 të Kushtetutës, pasi në asnjë dispozitë të ligjit nr. 107/2014 nuk parashikohet e drejta e parablerjes për ndërtimet e konfiskuara, për rrjedhojë nuk mund të ekzistojë as autorizimi për nxjerrjen e një akti nënligjor për këtë çështje. Për më tepër, ligji nr. 107/2014, në asnjë rast, nuk parashikon amnistinë e personave që kryejnë veprën penale të ndërtimit të paligjshëm nëpërmjet nënshkrimit të kontratës noteriale.

13.2.3 *Parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve*, pasi VKM-ja nr. 589/2022 ka përjashtuar nga ndjekja penale të gjitha subjektet zhvilluese që kanë ndërtuar pa leje ose në tejkalim të saj, duke bërë amnistinë e tyre. Ndërkohë që amnistia, në referim të nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, përbën një fushë, rregullimi i së cilës i rezervohet ekskluzivisht Kuvendit, përmes miratimit të ligjit me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Këshilli i Ministrave nuk mund të ketë kompetenca legjislative, përveç rasteve të parashikuara nga neni

101 i Kushtetutës. Ai nuk mund të ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit ose me akte nënligjore në ato fusha, rregullimi i të cilave, *expressis verbis*, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit. Përjashtimi nga ndjekja penale bie në kundërshtim me nenin 199/a të KP-së, që ka parashikuar veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”. Sikurse miratimi, edhe shfuqizimi ose depenalizimi i një veprë penale duhet domosdoshmërisht të realizohet me shumicë të cilësuar dhe jo nëpërmjet një VKM-je. Nga ana tjetër, VKM-ja nr. 589/2022 cenon *autonominë e pushtetit vendor*, të parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës, pasi sipas nenit 52, shkronja “e”, nënndarja “iv”, të ligjit nr. 107/2014, propozimi për konfiskim bëhet nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ose Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), dhe vendimi merret nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT). VKM-ja nuk parashikon të drejtën e propozimit për konfiskim nga ana e IMT-së, por vetëm të drejtën e njoftimit të IKMT-së, sipas parashikimeve të pikës 6 të VKM-së.

13.2.4 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi VKM-ja objekt kundërshtimi ka parashikuar një trajtim të diferencuar të subjekteve, të cilat, duke pasur mundësinë financiare, arrijnë t'i kalojnë shtetit sipërfaqet e ndërtuara pa leje përmes nënshkrimit të aktit noterial të kontratës së premtim shitjes, duke i përjashtuar ata nga ndjekja penale, në dallim nga shtetasit e tjerë, të cilët nuk e kanë këtë mundësi financiare, për të cilët ndiqet procedura e konfiskimit. Dallimi qëndron edhe midis subjekteve që ndërtojnë pa leje për qëllime fitimi dhe që nënshkruajnë aktin noterial dhe atyre që ndërtojnë pa leje jo për qëllime fitimi, të cilëve nuk u amnistohet vepra penale.

13.2.5 *Të drejtën e pronës*, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pasi VKM-ja nr. 589/2022 nuk ka parashikuar çfarë ndodh me pronarët e tokës që mund të kenë lidhur një kontratë sipërmarrjeje me zhvilluesin të cilit i konfiskohen sipërfaqet e ndërtuara pa leje ose personat e tretë që mund të kenë lidhur kontrata për fitimin e pronësisë të njërive të ndërtimit. Kjo është një çështje e parregulluar dhe e paadresuar as nga ligji nr. 107/2014. Në këtë drejtim, ligji dhe VKM-ja cenojnë parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, pasi edhe në rast se



sipërfaqja e punimeve është në masën 10.01%, masa e konfiskimit merret për të gjithë ndërtimin. Megjithëse objekt kërkimi është VKM-ja nr. 589/2022, në zbatim të nenit 48, paragrafi 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe vendimit nr. 65, datë 10.2.1999 të Gjykatës, kjo e fundit mund të marrë në shqyrtim edhe papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën në përputhje me parimin e disponibilitetit.

13.2.6 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, pasi VKM-ja nr. 589/2022 nuk jep asnjë garanci lidhur me procesin e rregullt ligjor. E gjithë procedura e ndjekur për konfiskimin nuk parashikon të drejtën për t'u njoftuar paraprakisht, për të paraqitur prova, kundërshtime, dëshmi, për t'u dëgjuar, për të marrë pjesë, për të kundërshtuar gjetjet etj. Njoftimi sipas pikës 13 të VKM-së u bëhet subjekteve vetëm pasi e gjithë vendimmarrja e KKT-së është ezauruar, madje pas daljes së urdhrat nga ministri përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore.

14. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar si vijon:

14.1. *Për juridiksionin e Gjykatës*

Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar VKM-në nr. 589/2022, pasi ajo nuk është një akt me karakter normativ, i drejtohet një grupi personash të përcaktueshëm që në rastin konkret janë ndërtuesit (zhvilluesit) e ndërtimeve për qëllime fitimi, të cilët kanë tejkaluar lejen e ndërtimit sipas rastit në masën 2% ose 10%, si dhe nuk përcakton norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt. Akti i kundërshtuar ka karakter shterues dhe i shtrin efektet te subjektet e përcaktuara në të dhe pas konfiskimit nuk sjell më asnjë pasojë. Pra, në thelb, VKM-ja është një akt administrativ individual/kolektiv.

14.2 *Për legjitimitimin e kërkuarit*

Në lidhje me legjitimitimin formal, kërkuari nuk plotëson kriterin numerik të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja "c", i Kushtetutës, pasi megjithëse në momentin e depozitimit kërkesa është nënshkruar nga 28 deputetë, në momentin e gjykimit të saj rezulton se dy nga deputetët nënshkruar nuk janë më deputetë. Kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka arsyetuar se cili interes publik cenohet nga zbatimi i VKM-së nr. 589/2022 ose cili është qëllimi dhe nxitja konkrete për të kërkuar kontrollin abstrakt të normës. Gjithashtu, kërkuari nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi pavarësisht se objekt i kërkesës

është VKM-ja nr. 589/2022, pretendimet e parashtruara, në thelb, lidhen me përmbajtjen e ligjit nr. 119/2020, që ka ndryshuar ligjin nr. 107/2014, i cili ka hyrë në fuqi në datën 24.11.2020. Për rrjedhojë, pretendimet në lidhje me përmbajtjen e tij janë paraqitur në tejkallim të afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000. Kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi VKM-ja nr. 589/2022 është një akt me karakter individual dhe jo normativ, sepse i referohet një fakti konkret dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative.

14.3. *Për themelin e kërkesës*

14.3.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave* nuk qëndron, pasi VKM-ja ka respektuar autorizimin e ligjit nr. 107/2014 në drejtëm të autoritetit kompetent për nxjerrjen e aktit, përcaktimit të çështjeve që duhen rregulluar, si dhe organit kompetent që duhet të mbajë në konsideratë interesin publik. Mundësia e përdorimit të objekteve të konfiskuara përbën përmbushje të autorizimeve të ligjvënës. Pretendimi i kërkuarit se duke barazuar aktin noterial me kërkesën për ndryshimin e lejes së ndërtimit, ligjërohet veprimtaria e ndërtimit të paligjshëm, nuk i përket rrafshit kushtetues, por vetëm atij ligjor, pasi kërkuari ka pretenduar mospërputhjen e VKM-së me KP-në dhe ligjin nr. 107/2014, jo me Kushtetutën. Gjithashtu, ai, në mënyrë jo të saktë, ka pretenduar se pika 3 e VKM-së nr. 589/2022 është në kundërshtim me VKM-në nr. 408/2015, duke e konsideruar këtë të fundit si akt më të ulët në hierarkinë e normave, megjithëse këto dy akte renditen në të njëjtin nivel. Nga ana tjetër, VKM-ja nr. 589/2022 nuk parashikon asnjë përjashtim nga ndjekja penale ose përgjegjësia penale.

14.3.2 Në kuptim të *rezervës ligjore*, nuk qëndron pretendimi se e drejta e parablerjes del përtej parashikimeve të dispozitave të ligjit autorizues, pasi ajo përbën një aspekt procedural në kushtet kur ligji nuk mund të parashikojë çdo element të procesit të konfiskimit. E drejta e parablerjes shërben për të rregulluar situatën e paligjshmërisë dhe krijohet me kontratë për të garantuar ruajtjen e raportit midis sendit dhe personave që kanë marrëdhënie të veçantë me të, në ndryshim nga të tretët. Akti noterial lidhet në formë të vullnetshme nga subjekti përpara fillimit të procesit të



konfiskimit për të përshpejtuar dhe ekonomizuar procesin e konfiskimit. Ky akt noterial në asnjë rast nuk shmang zbatimin e ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar (*ligji nr. 9874/2008*) dhe për më tepër udhëzimi nr. 27/2022 në pikën 9 ka referuar procedurat e transferimit të të tretët në zbatim të këtij ligji.

14.3.3 Pretendimet për cenimin e *parimit të ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve* janë të pabazuara, pasi VKM-ja nr. 589/2022 nuk përmban asnjë dispozitë amnistuese, për rrjedhojë nuk cenon asnjë nga kompetencat e Kuvendit. Për më tepër, kjo VKM ka përcaktuar se nuk ka amnisti për kundërvajtjet administrative, pra aq më pak për veprat penale që ndërtuesit mund të kenë kryer. VKM-ja nuk ndalon ndjekjen penale ndaj personave që kanë kryer këtë vepër penale, pasi procedimi penal është i pavarur nga procedimi administrativ për vënien e gjobës ose konfiskimin e objektit si dënim administrativ. Subjektet zhvilluese në mënyrë të vullnetshme pranojnë faktin se objekti është ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit.

14.3.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi VKM-ja nuk parashikon amnisti penale për asnjë subjekt, dhe as amnisti administrative. Ajo nuk ka përcaktuar ndonjë tarifë të cilën ndërtuesi duhet t’ia paguajë shtetit me rastin e kalimit të së drejtës së pronësisë për sipërfaqet e ndërtuara pa leje, përkundrazi, vetë shteti do të paguajë vlerën 1 euro. Në asnjë moment nuk konstatohet trajtimi i diferencuar i subjekteve, të cilëve u është dhënë mundësia t’i blejnë këto sipërfaqe me një vlerë jo më të vogël se sa çmimi i tregut. Në rastin konkret, të gjitha subjektet zhvilluese, që kanë tejkaluar masën 2% të sipërfaqes së ndërtimit, janë në pozicion të barabartë, pasi atyre u ofrohet njësoj mundësia e shfrytëzimit të procedurës së parashikuar në pikën 2 të VKM-së, për sa i përket aktit noterial.

14.3.5 VKM-ja nr. 589/2022 nuk cenon *të drejtën e pronës*, pasi dispozita që pretendohet të jetë jo në përputhje me Kushtetutën, konkretisht neni 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarja “iv”, i ligjit nr. 107/2014, është një dispozitë ligjore, e cila mund t’i nënshtrohej vlerësimit të kushtetutshmërisë vetëm nëse objekt i kërkesës do të ishte ligji nr. 107/2014 dhe jo VKM-ja nr. 589/2022. Ky pretendim, duke u konsideruar si një kërkesë e re, është edhe jashtë

afatit ligjor 2 vjeçar, për rrjedhojë kërkuksi nuk legjitimohet *ratione temporis*. Në këtë drejtim, nuk gjen zbatim paragrafi 2 i nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000, pasi Gjykata nuk mund të tejkalojë kufijtë e shqyrtimit të çështjes kushtetuese, që me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së VKM-së objekt gjykimi, të shfuqizojë edhe ligjin autorizues. Referenca e kërkuksit në vendimin nr. 65, datë 10.2.1999 të Gjykatës nuk është e saktë, pasi në atë rast Gjykata shfuqizoi dispozita që qëndronin në të njëjtin nivel hierarkik të normave juridike në shqyrtim, në ndryshim nga rasti konkret.

14.3.6 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, pasi VKM-ja nuk ka shmangur asnjë procedurë ligjore, të cilën mund ta shfrytëzojnë subjektet që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat nga zbatimi i këtij akti. Për më tepër, pika 13 e VKM-së parashikon të drejtën dhe detyrimin e autoritetit përgjegjës për ndjekjen e procedurës së konfiskimit që të njoftojë për masën e konfiskimit të objektit personat ose subjektet që preken nga kjo masë, brenda 7 ditëve nga nxjerrja e urdhrit të ministrit përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore. Gjithashtu, në mbështetje të VKM-së nr. 589/2022, janë nxjerrë aktet përkatëse, të cilat parashikojnë në mënyrë të detajuar afatet dhe procedurat në zbatim të procedurës së konfiskimit të objekteve të ndërtuara pa leje për qëllime fitimi, për të siguruar të drejtën për proces të rregullt ligjor, siç është udhëzimi nr. 27/2022, si dhe vendimi i KKT-së për procedurat dhe afatet e konfiskimit për interes publik.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

15. Çështja e juridiksionit të Gjykatës është ngritur nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, i cili ka pretenduar se rasti në shqyrtim nuk hyn në juridiksionin kushtetues, pasi VKM-ja nr. 589/2022 nuk është një akt me karakter normativ. Ajo i drejtohet një grupi personash të përcaktueshëm që në rastin konkret janë ndërtuesit (zhvilluesit) e ndërtimeve për qëllime fitimi, të cilët kanë tejkaluar lejen e ndërtimit, të paktën në masën 2%. Po kështu, VKM-ja nuk përcakton norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, por një situatë konkrete administrative nëpërmjet së cilës



shtetit i kalojnë shtesat pa leje. Ajo ka karakter shterues dhe i shtrin efektet te subjektet e përcaktuara dhe pas konfiskimit nuk sjell më asnjë pasojë. Ndërkohë, kërkuesi nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me juridiksionin e Gjykatës.

16. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme, prandaj gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës Gjykata ndalet, paraprakisht, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj për shqyrtimin substancial të aktit (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se një akt me karakter normativ vendos norma të përgjithshme sjelljeje me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre për një kategori të pacaktuar subjektësh. Akti normativ është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij. Për sa i përket aktit individual, ai është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata ka identifikuar tre kritere që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: i) sipas subjekteve të cilave u drejtohet akti – subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktuar në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; ii) sipas objektit - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së

drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; iii) sipas karakterit shterues/joshterues - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022: i) u drejtohet zhvilluesve ose subjekteve të autorizuar prej tyre, që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi ose në tejkallim të saj. Ajo i referohet të gjithë kategorisë së zhvilluesve, duke cilësuar karakteristikat e kësaj kategorie, por nuk përcakton në mënyrë nominative individët; ii) për sa i takon objektin të saj, procedura për konfiskimin e objekteve të ndërtuara pa leje ose në tejkallim të saj, për qëllime fitimi, nuk i referohet një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës administrative, por përmban rregulla të përgjithshme në lidhje me këto procedura, të cilat nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt. Zbatimi i këtij vendimi kërkon nxjerrjen e akteve të tjera rregullatore për zbatimin e tij, sikurse ka ndodhur në rastin konkret. Kështu, në mbështetje të VKM-së nr. 589/2022 ka dalë udhëzimi nr. 27/2022, vendime të KKT-së për procedurat e ndryshimit të lejes së ndërtimit, si dhe vendime individuale të konfiskimit për çdo objekt; iii) Gjithashtu, efektet e kësaj VKM-je nuk janë shteruese me rregullimin e një shtate konkrete, ato shtrihen në mënyrë të vazhdueshme mbi të gjitha subjektet që ndërtojnë ose do të ndërtojnë në të ardhmen pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit. Pra, çdo subjekt i cili është zhvillues ose subjekt i autorizuar prej tij që ndërton pa leje ose në tejkallim të saj, apo do të jetë i tillë në të ardhmen, konsiderohet subjekt i kësaj VKM-je. Për rrjedhojë, nisur nga rrethi i subjekteve që u drejtohet dhe efektet që do të sjellë mbi to, VKM-ja nr. 589/2022 ka karakter joshterues.

20. Për sa më sipër, në ndryshim nga sa ka prapësuar subjekti i interesuar, Gjykata vlerëson se VKM-ja nr. 589/2022 ka karakter normativ dhe, në kuptim të nenit 131, shkronja “c”, të Kushtetutës, shqyrtimi i pajtueshmërisë së saj me Kushtetutën përfshihet në juridiksionin kushtetues.

*B. Për legjitimitimin e kërkesës**B.1 Për legjitimitimin racione personae*

21. Kërkuesi ka parashtruar se legjitimohet *ratione personae* në paraqitjen e kërkesës për shfuqizimin e VKM-së nr. 589/2022, pasi në aspektin formal për vënien në lëvizje të Gjykatës, subjekti kushtetues, jo më pak se një pesta e deputetëve, formësohet në momentin e paraqitjes së kërkesës. Në këtë moment të gjithë nënshkruesit e kërkesës kanë qenë deputetë dhe rezulton se dy prej tyre kanë hequr dorë nga mandati i deputetit një muaj më pas. Kolegji i Gjykatës ka verifikuar nëse kërkesa përmbushte kushtet formale dhe materiale për të kaluar në seancë plenare, në përputhje me nenet 27, 31 dhe 31/a të ligjit nr. 8577/2000. Ky ligj nuk parashikon verifikimin e legjitimitimit të kërkesës në asnjë fazë tjetër të gjykimit. Gjithashtu, edhe dy deputetët e tjerë që kanë zëvendësuar deputetët që kanë hequr dorë nga mandati, si dhe një deputete tjetër, kanë shprehur vullnetin e tyre për t'iu bashkuar këtij gjykimi kushtetues. Nga ana tjetër, sipas kërkesës, referuar nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ai bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për një interes publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret.

22. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në lidhje me legjitimitimin formal të kërkesës, ka prapësuar se ai nuk plotëson kriterin numerik të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, pasi, megjithëse në momentin e depozitimit kërkesa është nënshkruar nga 28 deputetë, në momentin e gjykimit të saj dy nga deputetët nënshkrues nuk e gëzonin më statusin e deputetit. Gjithashtu, kërkesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka përcaktuar interesin publik të cenuar nga zbatimi i VKM-së nr. 589/2022 ose se cili është qëllimi dhe nxitja konkrete për të kërkuar kontrollin abstrakt të këtij akti normativ.

23. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, të saj, ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetues që legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Për sa i takon legjitimitimit formal, të jo më pak se një të pestës së

deputetëve, ky subjekt është i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000. Ky i fundit i njeh subjektit kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, të drejtën e kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve normative.

24. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkesa me të cilën është vënë në lëvizje procesi kushtetues është paraqitur në datën 14.10.2022 nga një grup prej 28 deputetësh të Kuvendit, të cilët përbëjnë subjektin kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje u konstatua se në datat 7.11.2022 dhe 8.11.2022, dy prej deputetëve nënshkrues të kërkesës kanë hequr dorë nga mandati i deputetit dhe me vendimet nr. 211 dhe nr. 212, datë 1.12.2022 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, ata janë zëvendësuar nga dy deputetë të tjerë. Për rrjedhojë, në momentin që çështja ishte për shqyrtim në seancë plenare, dy nga deputetët nënshkrues të kërkesës nuk e gëzonin më këtë status. Gjithashtu, në datën 20.4.2023 tre deputetë të tjerë i kanë paraqitur Gjykatës kërkesën e tyre për shprehjen e vullnetit për t'iu bashkuar si nënshkrues kërkesës së paraqitur nga kërkesi.

25. Gjykata thekson se verifikimi i kriterëve formale të pranueshmërisë së kërkesës, pra dhe verifikimi i numrit të deputetëve që i drejtohen Gjykatës (jo më pak se një e pesta e deputetëve), realizohet në momentin e vënies në lëvizje të kontrollit kushtetues dhe ky kriter në atë fazë të shqyrtimit është plotësuar nga kërkesi. Po kështu, edhe në momentin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, në vijim të shprehjes së vullnetit të tre deputetëve të tjerë, ky kriter ka rezultuar i plotësuar, për sa kohë që kërkesi ka përsëri numrin e kërkuar nga dispozita kushtetuese, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkesa paraprahe e subjektit të interesuar në këtë drejtim është e pabazuar.

26. Për sa i përket pretendimit të subjektit të interesuar se kërkesa në shqyrtim nuk mbron një interes publik dhe në këtë kuptim as kërkesi nuk ka arritur ta justifikojë këtë interes, si dhe qëllimin konkret që e ka nxitur për të vënë në lëvizje gjykimin abstrakt të aktit normativ, Gjykata rithekson se kriteri kushtetues i “detyrimit për të



justifikuar interesin”, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 134 të Kushtetutës është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetues në dy kategori: subjekte të pakushtëzuara, që nuk kanë nevojë të provojnë ndonjë interes për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues dhe subjekte të kushtëzuara, që kanë legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet nr. 41, datë 16.5.2017; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 19, datë 15.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në lidhje me legjitimitimin e subjektit kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, Gjykata thekson se interesi publik i këtyre funksionarëve publikë është i prezumuar, pasi një kërkesë e tyre vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të aktit normativ dhe interesi që kërkohet të mbrohet lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Mbrojtja e sistemit normativ dhe parimeve shtetformuese, ndër të tjera, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale, të shpalosura në Kushtetutë, nuk është e kushtëzuar nga një interes subjektiv konkret. Në këtë kuptim, Gjykata pohon se qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 55, datë 27.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, kërkuesi, në cilësinë e një subjekti të pakushtëzuar, nuk ka nevojë të provojë interesin e tij për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues, për shkak të interesit publik që mbart dhe, si i tillë, legjitimohet *ratione personae* për të kërkuar kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së aktit të kundërshtuar. Ndërsa prapësimi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk mbron një interes publik, lidhet me natyrën e pretendimeve të ngritura në këtë gjykim kushtetues, prandaj do të analizohet në aspektin e legjitimitimit *ratione materiae* të kërkuetit.

B.2. Për legjitimitimin *ratione temporis*

29. Kërkuesi ka parashtruar se legjitimohet *ratione temporis* për paraqitjen e kërkesës, pasi VKM-ja nr. 589/2022 është miratuar në datën 7.9.2022 dhe ka hyrë në fuqi në datën 12.9.2022, ndërsa kërkesa është depozituar në datën 14.10.2022, pra

brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

30. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi pavarësisht se objekt i kërkesës është VKM-ja nr. 589/2022, pretendimet e parashtruara në kërkesë, në thelb, lidhen me përmbajtjen e ligjit nr. 119/2020, që ka ndryshuar ligjin nr. 107/2014, i cili ka hyrë në fuqi në datën 24.11.2020. Për rrjedhojë, pretendimet në lidhje me përmbajtjen e tij janë paraqitur në tejkalim të afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

31. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022, objekt i këtij gjykimi kushtetues, ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 122, datë 12.9.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 14.10.2022, pra brenda afatit ligjor të përcaktuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Gjithashtu, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, pretendimet e kërkuetit, në thelb, nuk lidhen me përmbajtjen e ligjit nr. 119/2020, i cili, mes të tjerash, me nenin 7 të tij ka ndryshuar edhe përmbajtjen e nenit 52, pika 1, shkronjat “e” dhe “ë”, të ligjit nr. 107/2014, duke parashikuar edhe kompetencën e Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullave dhe të procedurave për konfiskimin për interes publik, që është edhe baza ligjore për miratimin e VKM-së së kundërshtuar. Pretendimet e kërkuetit lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e aktit normativ të kundërshtuar, për të cilin është pretenduar pikërisht se është nxjerrë në tejkalim të kompetencave të dhëna nga ky ligj.

32. Për sa më sipër, përderisa kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1 i ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

B.3 Për legjitimitimin *ratione materiae*

33. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuetit lidhen me cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, të barazisë përpara ligjit, së drejtës së pronës dhe asaj për proces të rregullt ligjor, si dhe hierarkisë së normave dhe rezervës ligjore, të garantuara respektivisht nga nenet 4, 7, 18, 41, 42, 81, 116 dhe 118 të Kushtetutës.



34. Në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, kërkuesi ka pretenduar se VKM-ja nr. 589/2022 parashikon trajtim të diferencuar midis subjekteve që ndërtojnë pa leje ose në tejkalim të saj për qëllime fitimi dhe që nënshkruajnë aktin noterial dhe atyre që ndërtojnë pa leje, jo për qëllime fitimi, të cilëve nuk u amnistohet vepra penale. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022 trajton vetëm rrethin e subjekteve që ndërtojnë për qëllime fitimi, ndërkohë që kërkuesi e lidh pretendimin e tij për cenimin e nenit 18 të Kushtetutës me diferencimin midis kësaj kategorie dhe individëve ose kategori personash që ndërtojnë pa qëllimi fitimi. Nisur nga fakti se këta të fundit nuk janë subjekte të VKM-së, Gjykata vlerëson se pretendimi për trajtim të diferencuar të këtyre dy lloj subjektësh nuk mund të gjejë zbatim në këtë rast, për pasojë pretendimi i kërkuesit nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës. Ndërsa pretendimet e tjera të kërkuesit kanë natyrë kushtetuese dhe mbartin interes publik, ndaj, si të tilla, në vijim, do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1 Për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës në drejtim të hierarkisë së akteve normative dhe të rezervës ligjore

35. Kërkuesi ka pretenduar se akti noterial barazohet me kontratën e premtim shitjes, që përbën shprehje të interesit nga ana e zhvilluesit për ndryshimin e lejes së ndërtimit, duke ligjëruar në këtë mënyrë veprimtarinë e ndërtimit të paligjshëm. Ligji nr. 107/2014 në mënyrë taksative ka parashikuar kushtet për ndryshimin e lejes së ndërtimit duke referuar në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit të miratuar me VKM-në nr. 408/2015 dhe kërkesa për këtë ndryshim nuk mund të bëhet në raste të tjera. VKM-ja nr. 589/2022 e konsideron aktin noterial si kërkesë për ndryshimin e lejes së ndërtimit, duke cenuar kështu parimin e hierarkisë së normave, të parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës. Gjithashtu, VKM-ja bie në kundërshtim edhe me nenin 199/a të KP-së, pasi objekti me ndryshimin e lejes së ndërtimit do të konsiderohet në kushtet e ndërtimit të ligjshëm, për rrjedhojë do të përjashtohet nga objekti i veprës penale. Sipas kërkuesit, akti ka dalë në kushtet e cenimit të rezervës ligjore të parashikuar në nenin 118 të Kushtetutës, pasi në asnjë dispozitë të ligjit nr. 107/2014 nuk parashikohet e drejta e parablerjes për ndërtimet e konfiskuara, për

rrjedhojë nuk mund të ekzistojë as autorizimi për nxjerrjen e një akti nënligjor për këtë çështje. Për më tepër, ligji nr. 107/2014, në asnjë rast, nuk parashikon amnistinë e personave që kryejnë veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës noteriale.

36. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se mundësia e përdorimit të objekteve të konfiskuara përbën përmbushje të autorizimeve të ligjvënësit. Pretendimi i kërkuesit se duke barazuar aktin noterial me kërkesën për ndryshimin e lejes së ndërtimit, ligjërohet veprimtaria e ndërtimit të paligjshëm është e nivelit ligjor, pasi ka të bëjë me mospërputhjen e VKM-së me KP-në dhe ligjin nr. 107/2014. Gjithashtu, ai në mënyrë jo të saktë ka pretenduar se pika 3 e VKM-së nr. 589/2022 është në kundërshtim me Rregulloren e Zhvillimit të Territorit të miratuar me VKM-në nr. 408/2015, duke e konsideruar këtë të fundit si akt më të ulët në hierarkinë e normave, megjithëse këto dy akte renditen në të njëjtin nivel. VKM-ja nr. 589/2022 nuk parashikon në asnjë dispozitë të saj ndonjë përjashtim nga ndjekja penale ose përgjegjësia penale. Në kuptim të rezervës ligjore, e drejta e parablerjes përbën një aspekt procedural në kushtet kur ligji nuk mund të parashikojë çdo element të procesit të konfiskimit. E drejta e parablerjes shërben për të rregulluar situatën e paligjshmërisë dhe krijohet me kontratë për të garantuar ruajtjen e raportit midis sendit dhe personave që kanë marrëdhënie të veçantë me të, në ndryshim nga të tretët. Akti noterial lidhet në formë të vullnetshme nga subjekti përpara fillimit të procedurës së konfiskimit për të përshpejtuar dhe ekonomizuar këtë proces. Ky akt noterial, në asnjë rast, nuk shmanget zbatimin e ligjit nr. 9874/2008 dhe për më tepër udhëzimi nr. 27/2022 në pikën 9 ka referuar procedurat e transferimit të të tretët në zbatim të këtij ligji.

37. Gjykata vëren se sipas nenit 4, pika 1, të Kushtetutës, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në



sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2011; nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Piramida e akteve normative, e parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Neni 118, pika 1, i Kushtetutës përcakton se aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë, ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se këto dispozita i japin kuptimin kushtetues konceptit *rezervë ligjore*, nëpërmjet të cilit kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo *rezervë ligjore* krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë. Në këtë kuptim, nxjerrja e akteve nënligjore është konsideruar nga Gjykata si cenim i kufijve të rezervës ligjore kur ligji nuk ka bërë asnjë delegim tek ekzekutivi për të rregulluar një çështje konkrete (rezervë ligjore absolute) ose kur ekzekutivi ka rregulluar çështje të tjera nga ato që i ka deleguar ligjvënësi (rezerva ligjore relative) (*shih vendimet nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në rastin në shqyrtim, neni 52 i ligjit nr. 107/2014 parashikon kundërvajtjet administrative në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, pavarësisht nëse ato përbëjnë vepër penale. Ndër të tjera, në pikën 1, shkronja “e”, të këtij neni është

parashikuar si masë administrative edhe konfiskimi për interes publik ose strehim social i punimeve të kryera pa leje kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor nëse tejkalon masën 2% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë, në të cilat për shkak të qëndrueshmërisë së objektit është e pamundur prishja e saj (*nëndarja “iii”*), si dhe konfiskimi për interes publik, me propozim të IKMT-së ose IMT-së dhe vendim të KKT-së, i të gjithë objektit kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor nëse tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë, kur ndërtesa është e qëndrueshme dhe është në përputhje me planet e përgjithshme, si edhe me planet e detajuara vendore (*nëndarja “iv”*). Ligjvënësi në të njëjtën dispozitë ka autorizuar Këshillin e Ministrave për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të konfiskimit për interes publik.

41. Në zbatim të këtij autorizimi, VKM-ja nr. 589/2022 ka përcaktuar rregullat konkrete që duhet të zbatohen gjatë konfiskimit, duke parashikuar se përpara fillimit të kësaj procedure dhe deri në marrjen e vendimit të konfiskimit nga ana e KKT-së, zhvilluesi ose çdo subjekt i autorizuar prej tij, me akt noterial, kalon në favor të shtetit, me kontratë premtim shitjeje me vlerë 1 euro, të drejtën e pronës të sipërfaqeve të ndërtuara pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit, me qëllim përdorimin e tyre për nevoja të strehimit social apo për interes publik (*pika 2*). Sipas VKM-së, akti noterial përbën shprehjen e interesit të subjektit për një ndryshim të lejes së ndërtimit, e cila merret në shqyrtim nga KKT-ja. Nëse kërkesa pranohet, KKT-ja vendos ndryshimin e lejes përkatëse të ndërtimit, duke njohur të drejtën e ministrisë përkatëse për administrimin e pronave shtetërore si bashkëpërfutuese e objektit të ri, i cili do të konsiderohet si objekt i ndërtuar në kushtet e lejes së ndërtimit (*pika 3*). Ndërtimet e konfiskuara sipas këtij vendimi mund t'i transferohen me të drejtë parablerjeje subjektit zhvillues të objektit ose çdo subjekti të autorizuar prej tij, për një vlerë jo më të vogël se çmimi i tregut dhe fondet e siguruar do të përdoren për shpronësim, trajtim të posaçëm ose kompensime, me qëllim realizimin e punëve publike. Pagesa e çmimit të punimeve në tejkallim të lejes nuk e çliron subjektin nga detyrimi i pagesës së gjobës të parashikuar nga pika 1 e nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 (*pika 4*).



42. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, Gjykata vlerëson të theksojë paraprakisht se me anë të konfiskimit për interes publik të ndërtimeve pa leje për qëllime fitimi, ndërtimi i paligjshëm kalon në pronësi të shtetit. Kjo mënyrë e kalimit të pronësisë për ndërtimet që tejkalojnë sipas rastit masën 2% ose 10% të lejes së ndërtimit, të cilat, për shkak të qëndrueshmërisë së objektit, është e pamundur të prishen, është parashikuar nga neni 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarjet “iii” dhe “iv”, i ligjit nr. 107/2014. Duhet evidentuar, gjithashtu, se paligjshmëria e ndërtimit detyron shtetin që në procedurën e konfiskimit të gjejë mekanizmat e duhur për ta përshtatur ndërtimin me planet rregulluese të miratuara në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, por edhe për ta ligjësuar atë në funksion të administrimit të pronës, sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

43. Në zbatim të delegimit të ligjvënësit, VKM-ja nr. 589/2022 ka parashikuar të gjithë hapat e nevojshëm për kryerjen e procedurës së konfiskimit, duke përcaktuar rregullat konkrete për zbatimin e kësaj procedure, në drejtim të organit kompetent për nxjerrjen e aktit të konfiskimit, aspekteve procedurale që duhen rregulluar dhe përcaktimit të instrumenteve për të krijuar kushtet për ligjërimin e ndërtimit të paligjshëm të konfiskuar, me qëllim futjen e tij në qarkullimin civil. Në këtë mënyrë, VKM-ja në fjalë ka detajuar bazën ligjore (nenin 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarjet “iii” dhe “iv”, të ligjit nr. 107/2014) në lidhje me procedurën administrative të konfiskimit.

C.1.1. Për hierarkinë e akteve normative

44. Duke iu rikthyer pretendimeve të kërkuarit, Gjykata konstaton se ai pretendon cenimin e nenit 116 të Kushtetutës për dy arsye: i) ndryshimi i lejes së ndërtimit sipas pikës 3 të VKM-së nr. 589/2022 bie ndesh me nenin 48 të ligjit nr. 107/2014, që parashikon rastet e rishikimit të lejes së ndërtimit; ii) dhe objekti pa leje, me ndryshimin e lejes së ndërtimit sipas pikës 3 të VKM-së nr. 589/2022, do të konsiderohet në kushtet e ndërtimit të ligjshëm dhe, si i tillë, është në kundërshtim me nenin 199/a të KP-së që parashikon veprën penale të ndërtimit të paligjshëm.

45. Gjykata vëren se sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 589/2022, akti noterial me anë të të cilit zhvilluesi ose çdo subjekt i autorizuar prej tij kalon në favor të shtetit të drejtën e pronës të sipërfaqeve të ndërtuara pa leje ose në tejkalim të

lejes së ndërtimit, përbën shprehje të interesit për një ndryshim të lejes së ndërtimit. Nëse kërkesa pranohet nga KKT-ja, objekti do të konsiderohet si i ndërtuar në kushtet e lejes së ndërtimit (*pika 3*). Pra, “*ndryshimi i lejes së ndërtimit*” për ndërtimet pa leje ose në tejkalim të saj, i parashikuar në VKM-në nr. 589/2022, i referohet një situatë paligjshmërie të ndërtimit për shkaqe subjektive dhe ka si qëllim mundësinë e administrimit të objekteve të konfiskuara nga organet shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, të cilat për shkak të qëndrueshmërisë së objektit të ndërtuar, janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me pjesën tjetër të tij. Në këtë kuptim, duke qenë se ndërtimi i paligjshëm nuk mund të priset (sikurse është parashikuar në nënndarjet “i” dhe “ii” të shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014), “*ndryshimi i lejes së ndërtimit*” është instrument i përshtatshëm për realizimin e procedurës së konfiskimit. Në këtë mënyrë, në përmbushje të delegimit të ligjvënësit, janë rregulluar pasojat e procedurës së konfiskimit, pra ligjërimi i objektit të ndërtuar pa leje dhe i konfiskuar me qëllim përfshirjen e tij në qarkullimin civil.

46. Nga ana tjetër, neni 48 i ligjit nr. 107/2014 parashikon rastet e rishikimit të lejes së ndërtimit nëse gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit hasen situata të paparashikuara ekonomike dhe teknike që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të miratuar me lejen e ndërtimit. Kjo do të thotë se “*rishikimi i lejes së ndërtimit*” sipas ligjit nr. 107/2014 u referohet situatave për shkaqe objektive të paparashikuara në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit dhe ka për qëllim përshtatjen e saj (lejes) me ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit. Objekti i ndërtimit në këtë rast nuk është i paligjshëm, por për shkaqe ekonomike dhe teknike ai nuk mund të realizohet sipas kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar. Rastet dhe procedura përkatëse për rishikimin e lejes së ndërtimit, sipas autorizimit në pikën 3 të nenit 48 të ligjit nr. 107/2014, detajohen në rregulloren e zhvillimit të territorit, e cila është miratuar me VKM-në nr. 408/2015.

47. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se instrumenti i “*ndryshimit të lejes së ndërtimit*”, i parashikuar nga pika 3 e VKM-së nr. 589/2022 dallon nga ai i “*rishikimit të lejes së ndërtimit*”, i parashikuar nga neni 48 i ligjit nr. 107/2014, si në lidhje me situatat dhe shkaqet të cilave secili prej tyre u referohet, ashtu edhe me mënyrën e zgjidhjes



së pasojave që synon të rregullojë. Prandaj, Gjykata vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet dispozitave në fjalë lidhet me rregullimin e aspekteve juridike të ndryshme të objekteve në ndërtim. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit nuk hyn në sferën e nenit 116 të Kushtetutës dhe hierarkia e akteve normative nuk mund të gjejë zbatim në rastin konkret.

48. Nisur nga këto premisa, pretendimi i kërkuesit se VKM-ja nr. 589/2022 bie ndesh me Rregulloren e Zhvillimit Urban, të miratuar me VKM-në nr. 408/2015, nuk mund të merret në shqyrtim për sa kohë që, në thelb, lidhet me konfliktin ndërmjet normave ligjore të të njëjtut nivel, çka përbën një çështje që del jashtë juridiksionit kushtetues. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy akteve normative të të njëjtut nivel. Po kështu, mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të akteve normative dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tyre me akte normative të tjera, nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues, për rrjedhojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata (*sibih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 5, datë 5.2.2015; nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Për sa i takon pretendimit të kërkuesit se objekti pa leje me ndryshimin e lejes së ndërtimit do të konsiderohet në kushtet e ndërtimit të ligjshëm, pra do të përjashtohet nga vepra penale, e, si i tillë, bie në kundërshtim me nenin 199/a të KP-së, që parashikon veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022 përcakton se me ndryshimin e lejes së ndërtimit, nëse kërkesa pranohet, objekti do të konsiderohet i ndërtuar në kushtet e lejes së ndërtimit (*pika 3*). Pavarësisht këtij parashikimi, në fjalinë e dytë të pikës 4 të kësaj VKM-je, kur sanksionohet e drejta e parablerjes e objektit të konfiskuar, në mënyrë të shprehur citohet se pagesa e çmimit të punimeve në tejkallim të lejes nuk e çliron subjektin nga detyrimi i pagesës së gjobës të parashikuar nga pika 1 e nenit 52 të ligjit nr. 107/2014. Ky parashikim ligjor, sikurse u theksua edhe më sipër, përfshin shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative në kuptim të këtij ligji, pavarësisht nëse ato përbëjnë veprë penale.

50. Gjykata, referuar përmbajtjes së VKM-së nr. 589/2022, vëren se ajo nuk ka parashikuar në

dispozitat e saj, në mënyrë të shprehur, rregulla për përjashtimin nga përgjegjësia penale të subjekteve që kanë ndërtuar pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit. Parashikimi i pikës 3 të saj, sipas të cilit objekti i paligjshëm me ndryshimin e lejes së ndërtimit do të konsiderohet në kushtet e lejes së ndërtimit, edhe pse *prima facie* krijon idenë se riparson faktin e paligjshëm në drejtim të autorit të tij, pra amnistion veprën penale, në fakt ka për qëllim rregullimin e pasojave të procedurës së konfiskimit për interes publik. Në këtë kuptim, ligjërimi i ndërtimit të paligjshëm synon mundësinë e administrimit të objekteve të konfiskuara nga organet shtetërore sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk zhbën në vetvete veprimin e paligjshëm të ndërtimit pa leje ose në tejkallim të saj. Kjo do të thotë se ndryshimi i lejes së ndërtimit nuk nënkupton ligjërimin e sjelljes penale ose administrative të subjektit zhvillues. Për më tepër, ky shkak, duke mos u parashikuar si rast i parashkrimit të ndjekjes penale ose i dënimit penal, sipas dispozitave relevante të KP-së, nuk mund të sjellë në asnjë rast shuarjen e veprës penale.

51. Për rrjedhojë, në situatën kur subjektet që kanë ndërtuar pa leje ose në tejkallim të saj procedohen penalisht, parashikimi i pikës 3 të VKM-së nr. 589/2022 rregullon pasojat civile të kundërvajtjes administrative, por nuk përjashton përgjegjësinë penale të tyre. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se procedimi penal është i pavarur nga procedimi administrativ i konfiskimit të objektit të paligjshëm. Për më tepër, duke qenë se sipas pikës 4 të VKM-së këto subjekte nuk çlirohen as nga detyrimi për pagesën e kundërvajtjes administrative, aq më pak ata mund të përjashtohen në mënyrë të nënkuptuar ose indirekte nga përgjegjësia penale. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e nenit 116 të Kushtetutës është i pabazuar.

C.1.2. Për rezervën ligjore

52. Sipas kërkuesit, VKM-ja ka dalë edhe në kushtet e cenimit të rezervës ligjore të parashikuar në nenin 118 të Kushtetutës, për dy arsye: i) në asnjë dispozitë të ligjit nr. 107/2014 nuk parashikohet e drejta e parablerjes për ndërtimet e konfiskuara e parashikuar në VKM-në nr. 589/2022; ii) dhe ligji nr. 107/2014 nuk parashikon amnistinë e personave që kryejnë veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, nëpërmjet nënshkrimit të



kontratës noteriale, sikurse ata do të konsiderohen nga VKM-ja nr. 589/2022.

53. Në pikën 4 të VKM-së nr. 589/2022 parashikohet e drejta e parablerjes e subjektit zhvillues të objektit të konfiskuar ose e çdo subjekti të autorizuar prej tij për një vlerë jo më të vogël se sa çmimi i tregut. Gjithashtu, nëse subjekti shpreh interesin për të parablerë punimet pa leje, ministri përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore kryen procedurën e parablerjes dhe bën derdhjen e fondit përkatës në llogarinë e të ardhurave të thesarit në degë me destinacion llogarinë speciale të shpronësimeve pranë Bankës së Shqipërisë (*pika 12*).

54. Gjykata konstaton se e drejta e parablerjes mund të burojë nga ligji (kur parashikohet shprehimisht nga ligji ose një akt nënligjor) ose nga kontrata (kur palët parashikojnë, rast pas rasti, njohjen e kësaj të drejte në marrëveshjet e tyre). Në çdo rast koncepti i së drejtës së parablerjes ligjore jepet nga Kodi Civil (KC), i cili në nenin 204 parashikon se bashkëpronari, përpara se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë.

55. Gjykata vëren se sipas parashikimit të nënndarjes “iii” të shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014, në rastin kur ndërtimi tejkalon 2% të sipërfaqes ndërtimore, shteti konfiskon vetëm punimet e kryera pa leje, ndërsa sipas parashikimit të nënndarjes “iv” të po të njëjtut nen, kur ndërtimi tejkalon 10% të sipërfaqes ndërtimore konfiskohet për interes publik i gjithë objekti. Pra pavarësisht masës së objektit që konfiskohet, në çdo rast, me konfiskimin e ndërtimeve pa leje, krijohet një situatë bashkëpronësie mbi një send të paluajtshëm midis shtetit, nga njëra anë, dhe subjektit zhvillues dhe/ose pronarëve të trullit apo personave të tretë, nga ana tjetër. Prandaj, nëpërmjet parashikimit të institutit të parablerjes, VKM-ja, me qëllim garantimin e të drejtave të bashkëpronarëve të sendit, ka disiplinuar situatën juridike të kësaj bashkëpronësie sipas rregullave të legjislacionit civil në fuqi. Kjo do të thotë që edhe nëse VKM-ja nr. 589/2022 nuk do të parashikonte në mënyrë të shprehur të drejtën e parablerjes, ajo, gjithsesi, do të gjente zbatim sipas përcaktimeve të KC-së.

56. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se e drejta e parablerjes e parashikuar nga VKM-ja është një instrument për të realizuar procedurën e konfiskimit për interes publik në kuadër të delegimit të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014. Në rast të shfaqjes së vullnetit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, shteti realizon interesin publik nëpërmjet arkëtimit të vlerës së sendit, sipas çmimit të tregut. Nëse kjo e drejtë nuk ushtrohet, shteti do të vazhdojë të ketë pronësinë e sendit, i cili do t'u nënshtrohet rregullave të administrimit të pasurive publike, përfshirë zbatimin e shitjes së tij në ankand. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se qëllimi i ligjit “konfiskimi për interes publik” në çdo rast realizohet, pasi objektet e ndërtuara pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit, ose vlera e tyre sipas çmimit të tregut, në përfundim të procedurës së konfiskimit, i kalojnë shtetit. Prandaj, pretendimi i kërkuesit për cenimin e rezervës ligjore është i pabazuar.

57. Pretendimi i dytë i kërkuesit për cenimin e nenit 118 të Kushtetutës lidhet me amnistinë nga ana e VKM-së të personave subjekt të veprës penale, në mungesë të delegimit nga ana e ligjit nr. 107/2014. Në këtë drejtim, jurisprudenca kushtetuese është shprehur edhe për kuptimin kushtetues e ligjor të amnistisë. Gjykata ka pohuar se amnistia përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe, ose dënimeve përkatëse. Amnistia e veprës penale vepron përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit, me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer, ndërsa amnistia e dënimit ndërhyr pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit dhe të dënimeve plotësuese, edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndryshimi midis tyre qëndron në faktin se amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), ndërsa amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2014; nr. 16, datë 19.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Duke marrë në konsideratë se ky pretendim është trajtuar tek analiza e përgjegjësisë penale të subjekteve që kanë kryer veprime të paligjshme (*shih paragrafin 50*), Gjykata me të njëjtin arsyetim,



vlerëson se VKM-ja nuk sjell amnistinë e personave që kanë kryer ndërtime pa leje.

59. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, në drejtim të parimit të hierarkisë së akteve normative dhe rezervës ligjore, nuk është i bazuar.

C.2 Për cenimin e parimit të ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve

60. Kërkuar pretendon se: i) VKM-ja nr. 589/2022 ka përjashtuar nga ndjekja penale të gjitha subjektet zhvilluese që kanë ndërtuar pa leje ose në tejkallim të saj, duke bërë amnistinë e tyre. Ndërkohë që amnistia, në referim të nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, përbën një fushë, rregullimi i së cilës i rezervohet ekskluzivisht Kuvendit, përmes miratimit të ligjit me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Këshilli i Ministrave nuk mund të ketë kompetenca legjislative, përveç rasteve të parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës. Ai nuk mund ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit ose me akte nënligjore në ato fusha, rregullimi i të cilave, *expressis verbis*, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit. Përjashtimi nga ndjekja penale bie në kundërshtim me nenin 199/a të KP-së që ka parashikuar veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”. Sikurse miratimi, edhe shfuqizimi ose depenalizimi i një veprë penale duhet domosdoshmërisht të realizohet me shumicë të cilësuar dhe jo nëpërmjet një VKM-je; ii) Gjithashtu, sipas kërkuarit, VKM-ja nr. 589/2022 cenon edhe autonominë e pushtetit vendor, të parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës, pasi sipas nenit 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarja “iv”, të ligjit nr. 107/2014, propozimi për konfiskim bëhet nga IKMT-ja ose IMT-ja dhe vendimi merret nga KKT-ja. VKM-ja nuk parashikon të drejtën e propozimit për konfiskim nga ana e IMT-së, por vetëm të drejtën e njoftimit të IKMT-së sipas parashikimeve të pikës 6 të VKM-së.

61. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se VKM-ja nr. 589/2022 nuk përmban asnjë dispozitë amnistuese, rrjedhimisht nuk cenon asnjë nga kompetencat e Kuvendit. Për më tepër, ajo ka përcaktuar se nuk ka amnisti për kundërvajtjet administrative, pra aq më pak për veprat penale që ndërtuesit mund të kenë kryer. VKM-ja nuk ndalon ndjekjen penale ndaj personave që kanë kryer këtë vepër penale, pasi procedimi penal është i pavarur nga procedimi administrativ për vënien e gjobës ose konfiskimin e

objektit si dënim administrativ. Subjektet zhvilluese, në mënyrë të vullnetshme, pranojnë faktin se objekti është ndërtuar në tejkallim të lejes së ndërtimit.

62. Gjykata në jurisprudencën e saj, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës, që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve, ka theksuar se ai synon të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi ose të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Nëpërmjet këtij parimi kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t’i marrë ose t’i anashkalojë ato me vullnetin e tij. Ky parim përfshin pushtetet në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore) (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 24, datë 9.6.2011; nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022 ka përcaktuar rregullat dhe procedurat e konfiskimit të sipërfaqeve të ndërtuara pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit. Sikurse u theksua më sipër, akti i kundërshtuar nuk i përjashton subjektet nga përmbushja e detyrimeve dhe përgjegjësisë ligjore penale, për rrjedhojë ndaj tyre nuk zbatohet ndonjë formë amnistie ndaj këtyre përgjegjësisë (*shih paragrafin 50*). Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se në kushtet kur akti i kundërshtuar nuk parashikon amnistinë e ndonjë veprimi të paligjshëm, kompetencat e Kuvendit lidhur me dhënien e amnistisë për kategori të caktuara të individëve që kanë kryer vepra penale nuk janë cenuar.

64. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit për cenimin e autonomisë së pushtetit vendor, të parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës, pasi VKM-ja nr. 589/2022 nuk parashikon të drejtën e propozimit për konfiskim nga ana e IMT-së, por vetëm të drejtën e njoftimit IKMT-së, sipas parashikimeve të pikës 6 të saj, Gjykata vëren se sipas nenit 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarja “iv”, të ligjit nr. 107/2014, konfiskimi për interes publik bëhet me propozim të IKMT-së ose IMT-së dhe vendimi merret nga KKT-ja. Ndërkohë, VKM-ja nr. 589/2022 në pikën 6 parashikon se procedura e konfiskimit fillon me propozimin e IKMT-së, sipas



inspektimeve periodike të kryera kryesisht ose pas marrjes së njoftimit nga IMT-ja.

65. Gjykata vëren se ligji nr. 107/2014 ka parashikuar të drejtën e propozimit të konfiskimit në mënyrë alternative, IKMT-ja ose IMT-ja, ndërsa VKM-ja ka detajuar dhe saktësuar këtë të drejtë, duke ia atribuar atë IKMT-së, bazuar edhe në njoftimin e IMT-së, sipas fushës së përgjegjësisë, të parashikuar po në pikën 6 të VKM-së. Në këtë mënyrë, në vlerësimin e Gjykatës, në thelb, IMT-ve nuk i është cenuar sfera e tyre e kompetencave, duke qenë se edhe nëpërmjet këtij parashikimi ato kanë të njëjtin rol të atribuar me ligj në fillimin e procedurës së konfiskimit.

66. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve nuk është i bazuar.

C.3 Për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit

67. Kërkuari ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi VKM-ja objekt kundërshtimi ka parashikuar një trajtim të diferencuar të subjekteve, të cilat, duke pasur mundësinë financiare, arrijnë t'i kalojnë shtetit sipërfaqet e ndërtuara pa leje përmes nënshkrimit të aktit noterial të kontratës së premtim shitjes, duke i përjashtuar ata nga ndjekja penale, në dallim nga shtetasit e tjerë, të cilët nuk e kanë këtë mundësi financiare, për të cilët ndiqet procedura e konfiskimit.

68. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se VKM-ja nr. 589/2022 nuk parashikon amnisti penale për asnjë subjekt dhe as amnisti administrative. Ajo nuk ka përcaktuar ndonjë tarifë të cilën ndërtuesi duhet t'ia paguajë shtetit me rastin e kalimit të së drejtës së pronësisë për sipërfaqet e ndërtuara pa leje, përkundrazi, vetë shteti do të paguajë vlerën 1 euro. Në asnjë moment nuk konstatohet trajtimi i diferencuar i subjekteve që u është dhënë mundësia t'i blejnë këto sipërfaqe me një vlerë jo më të vogël se sa çmimi i tregut. Në rastin konkret, të gjitha subjektet zhvilluese që kanë tejkalluar masën 2% të sipërfaqes së ndërtimit janë në pozicion të barabartë, pasi atyre u ofrohet njësoj mundësia e shfrytëzimit të procedurës së parashikuar në pikën 2 të VKM-së, për sa i përket aktit noterial.

69. Në mendimin e tij me shkrim të datës 30.1.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, fillimisht, ka evidentuar se VKM-ja objekt kundërshtimi ka parashikuar diferencim

midis subjekteve që bëjnë marrëveshje noteriale dhe atyre që nuk e bëjnë një të tillë, por u nënshtrohen procedurave të konfiskimit. Pavarësisht se ky akt është me natyrë administrative dhe nuk ndikon në juridiksionin penal, baza për trajtimin e diferencuar duhet të arsyetohet lidhur me qëllimet që synohen të arrihen. Sipas këtij mendimi, nëse lidhja e marrëveshjes noteriale mund të krijojë dyshime, duke sjellë trajtim të diferencuar të subjekteve për të njëjtën shkelje, ky parashikim mund të krijojë premisa për dyshim të arsyeshëm të shkeljes së parimit të barazisë përpara ligjit. Në vijim, në datën 19.5.2023, pas marrjes dijeni të informacionit të dërguar nga organet ligjzbatuese, të cilat ndjekin procedurat administrative dhe penale për subjektet që kanë ndërtuar pa leje për qëllime fitimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua sërish Gjykatës me një mendim të dytë, me argumentin se mendimi i dërguar më herët nuk reflektonte situatën faktike juridike. Nisur nga fakti se sipas informacioneve të vëna në dispozicion rezulton se të gjitha rastet e proceduara nga IKMT-ja në zbatim të VKM-së nr. 589/2022 janë kallëzuar në prokurori, në referim të nenit 199/a të KP-së, Komisioneri ka shprehur mendimin se akti objekt shqyrtimi nuk ka ndikuar në zbatueshmërinë efektive të juridiksionit penal, duke mos vendosur në pozita të pabarabarta subjekte të ndryshme që ndodhen në situata të njëjta.

70. Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit, ndër të tjera, për shkak të gjendjes ekonomike, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, por vetëm nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 27,*



datë 29.6.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

71. Për të vlerësuar nëse një akt normativ është diskriminues, Gjykata shqyrton nëse ai parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por duhet edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënës të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, ato duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton diferencimin e përligjur dhe arsyen objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

72. Në rastin konkret, Gjykata vëren që pavarësisht se VKM-ja nr. 589/2022 i ka dhënë mundësinë e së drejtës së parablerjes subjektit zhvillues ose çdo subjekti të autorizuar prej tij, i cili ka ndërtuar pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit, ky fakt nuk përbën diferencim midis subjekteve që ushtrojnë këtë të drejtë dhe atyre që nuk e ushtrojnë. Sipas rregullave të parashikuara nga VKM-ja në rast të ndërtimeve pa leje ose në tejkalim të saj, gjithmonë subjektet do t'i nënshtrohen procedurës së konfiskimit të pasurisë nga ana e shtetit, pasi janë në të njëjtat kushte paligjshmërie. Konfiskimi në çdo rast do të kryhet dhe ndërtimi i paligjshëm do të bëhet pronë shtetërore. Nëse ndërtimet e konfiskuara i transferohen për shkak të së drejtës së parablerjes subjektit zhvillues, shteti do të përfitojë vlerën e sendit sipas çmimit të tregut. Për më tepër, theksohet se subjektet e kësaj VKM-je i përkasin kategorisë së subjekteve që kanë ndërtuar pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit për qëllime fitimi, për të cilët VKM-ja parashikon të njëjtën mundësi, atë të parablerjes së objektit me çmimin e tregut. Për pasojë, pretendimi i kërkuesit për diferencim të këtyre subjekteve për shkak të mundësive financiare nuk është i bazuar.

73. Gjithashtu, Gjykata evidenton se me anë të VKM-së subjektet që nënshkruajnë aktin noterial nuk përjashtohen nga ndjekja penale ose

kundërvajtja administrative. Me fjalë të tjera, pavarësisht mundësisë që atyre u jepet për të ndryshuar lejen e ndërtimit ose më pas për të parablerë ndërtimin pa leje, ata sërish u nënshtrohen të njëjtave normave dhe procedurave për ndëshkimin e paligjshmërisë së kryer (*shih paragrafin 50*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, për shkak të amnistisë së veprës penale, nuk është i bazuar.

74. Gjykata thekson se arriti në përfundimin e mësipërm, duke mos u mbështetur në asnjë nga opinionet e dhëna nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se për nga natyra e tyre të tilla mendime (*amicus curia*), të kërkuara gjatë procesit kushtetues, kanë natyrë këshillimore dhe se ajo në çdo rast arrin në përfundimin e saj në lidhje me çështjen mbi bazën e vlerësimit të pavarur të të gjitha fakteve të saj dhe parashtrimeve e pretendimeve të palëve pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues.

C.4 Për cenimin e së drejtës së pronës

75. Kërkuesi ka pretenduar se VKM-ja nr. 589/2022 dhe ligji nr. 107/2014 nuk kanë parashikuar se çfarë ndodh me pronarët e tokës që mund të kenë lidhur një kontratë sipërmarrjeje me zhvilluesin, që i konfiskohen sipërfaqet e ndërtuara pa leje ose personat e tretë, të cilët mund të kenë lidhur kontrata për fitimin e pronësisë së njësive të ndërtimit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e pronës të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, nuk respektohen garancitë e nenit 17, për sa i përket parimit të proporcionalitetit, pasi edhe në rast se sipërfaqja e punimeve është në masën 10.01%, merret masa e konfiskimit për të gjithë ndërtimin. Megjithatë objekt kërkimi është VKM-ja nr. 589/2022, në zbatim të nenit 48, paragrafi 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe vendimit nr. 65, datë 10.2.1999, Gjykata mund të marrë në shqyrtim edhe papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën në përputhje me parimin e disponibilitetit.

76. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është jashtë objektit të kërkesës, pasi dispozita që pretendohet të jetë jo në përputhje me Kushtetutën është një dispozitë ligjore, e cila mund t'i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë vetëm nëse objekt i kërkesës do të ishte ligji nr. 107/2014



dhe jo VKM-ja nr. 589/2022. Ky pretendim, duke u konsideruar si një kërkesë e re, është edhe jashtë afatit ligjor 2 vjeçar, për rrjedhojë kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*. Në këtë drejtim, Gjykata nuk mund të tejkalojë kufijtë e shqyrtimit të çështjes kushtetuese, që me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së VKM-së objekt gjykimi, të shfuqizojë edhe ligjin autorizues.

77. Gjykata ka evidentuar se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, e drejta e pronës private është e garantuar dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik. E drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe se në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 36 datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

78. Gjykata rithekson se objekt i VKM-së nr. 589/2022 janë ndërtimet pa leje ose në tejkallim të saj, pra ndërtimet e paligjshme, që për shkak të qëndrueshmërisë së objektit, nuk mund të prishen. Fakti që ajo nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur pasojat që vijnë për pronarët e truallit ose personat e tretë që kanë blerë në mënyrë të ligjshme dhe në mirëbesim, nuk do të thotë se atyre u është cenuar e drejta e pronës.

79. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se kur ndërtimet pa leje tejkalojnë në masën 2% sipërfaqen totale ndërtimore (*sipas nenit 52, pika 1, shkronja "e", nënndarja "iii" e ligjit*) konfiskohet vetëm pjesa e ndërtimit pa leje, ndërsa në rastin kur ndërtimi i paligjshëm tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore (*sipas nënndarjes "iv" të të njëjtit nen*) konfiskohet i gjithë objekti i ndërtuar. Gjithsesi, nuk rezulton që VKM-ja, e nxjerrë në zbatim të ligjit, të mohojë apo kufizojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar të drejtat e pronarëve të truallit dhe personave të tretë. Në çdo rast ata kanë në dispozicion mjetet e mbrojtjes së të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe mbrojtjen e tyre gjyqësore, sipas rastit ndaj shtetit, subjektit zhvillues të pronës, ose personave të tjerë me të cilët kanë krijuar marrëdhënie

juridike, pasi në këtë rast do të gjejnë zbatim parimet dhe parashikimet e legjislacionit civil në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë dhe marrëdhëniet e tjera me natyrë kontraktore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuetit se VKM-ja cenon të drejtën e pronës të pronarëve të truallit apo të personave të tretë nuk është i bazuar.

80. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se të drejtat e pronarëve të truallit dhe personave të tretë nuk cenohen, në rastin kur ndërtimet pa leje tejkalojnë në masën 2% sipërfaqen totale ndërtimore (*sipas nenit 52, pika 1, shkronja "e", nënndarja "iii", të ligjit*), sepse konfiskohet vetëm pjesa e ndërtimit pa leje, ndërkohë që pjesa e ndërtimit të ligjshëm vazhdon të jetë në pronësi të zhvilluesit. Po kështu, në rastin kur ndërtimi i paligjshëm tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore (*sipas nënndarjes "iv" të të njëjtit nen*) dhe konfiskohet i gjithë objekti, konfiskimi nuk shtrihet mbi të drejtën e pronësisë së pronarit të truallit. Gjithsesi, pronarët e truallit dhe personat e tretë, në çdo rast, kanë në dispozicion mjetet e mbrojtjes së të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi. Ata kanë të drejtë të kërkojnë në rrugë gjyqësore të drejtat e tyre, sipas rastit, ndaj shtetit, subjektit zhvillues të pronës ose personave të tjerë me të cilët kanë krijuar marrëdhënie juridike, pasi në këtë rast do të gjejnë zbatim parimet dhe parashikimet e legjislacionit civil në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë dhe marrëdhëniet e tjera me natyrë kontraktore³. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuetit se VKM-ja cenon të drejtën e pronës të pronarëve të truallit ose të personave të tretë nuk është i bazuar.

81. Në lidhje me pretendimet e kërkuetit se nuk respektohen garancitë e nenit 17, për sa i përket parimit të proporcionalitetit, pasi edhe në rast se sipërfaqja e punimeve është në masën 10.01%, merret masa e konfiskimit për të gjithë ndërtimin, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me

³ Gjyqtarja Marjana Semini në shtesë të analizës së mësipërme, mban qëndrimin se me kalimin e të drejtave nga një kreditor i vjetër te një i ri (shteti pas konfiskimit), të drejtat e fituara me kontratat përkatëse mbi ndërtimin e sendit të ardhshëm nga pronarët e truallit dhe personat e tretë nuk cenohen, sepse çdo e drejtë që i kalon shtetit me konfiskimin shtrihet deri në masën dhe kufijtë që i ka pasur zhvilluesi dhe bashkë me të drejtën/at kalojnë edhe detyrimet që burojnë sipas rastit nga marrëdhëniet kontraktore ose ato të pronësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit civil.



përcaktimin e masës së tejkalimit të lejes së ndërtimit, për të cilën konfiskohet i gjithë objekti i ndërtuar, e cila, sikurse u përmend edhe më sipër, nuk është parashikuar nga VKM-ja, por nga neni 52, pika 1, shkronja “e”, nënndarja “iv”, i ligjit nr. 107/2014. Duke qenë se ky i fundit nuk është objekt i kërimit të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim.

82. Në përmbledhje të argumenteve si më sipër, Gjykata vlerëson se VKM-ja nuk cenon të drejtën e pronës. Për këtë arsye, pretendimi i kërkuarit për shqyrtimin e ligjit nr. 107/2014 për shkak të lidhjes me VKM-në (neni 48, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000), nuk mund të merret në shqyrtim.

C.5 Për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor

83. Kërkuari ka pretenduar se e gjithë procedura e ndjekur për konfiskimin e rregulluar nga VKM-ja nr. 589/2022 nuk ka parashikuar të drejtën për t'u njoftuar paraprakisht, të drejtën për të paraqitur prova, kundërshtime, dëshmi, për t'u dëgjuar, për të marrë pjesë, për të kundërshtuar gjetjet etj. Njoftimi sipas pikës 13 të VKM-së objekt kundërshtimi u bëhet subjekteve vetëm pasi e gjithë vendimarrja e KKT-së është ezauruar, madje pas daljes së urdhrit nga ministri përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore.

84. Subjekti i interesuar ka prapësuar se VKM-ja nr. 589/2022 nuk ka shmangur asnjë procedurë ligjore, të cilën mund ta shfrytëzojnë subjektet që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat nga zbatimi i këtij akti. Për më tepër, pika 13 e VKM-së parashikon të drejtën dhe detyrimin e autoritetit përgjegjës për ndjekjen e procedurës së konfiskimit që të njoftojë për masën e konfiskimit të objektit personat ose subjektet që preken nga kjo masë brenda 7 ditëve nga nxjerrja e urdhrit të ministrit përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore. Gjithashtu, nëpërmjet VKM-së nr. 589/2022 janë nxjerrë aktet përkatëse, të cilat parashikojnë në mënyrë të detajuar afatet dhe procedurat në zbatim të procedurës së konfiskimit të objekteve të ndërtuara pa leje për qëllime fitimi, për të siguruar të drejtën për proces të rregullt ligjor.

85. Neni 42, paragrafi 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një

afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

86. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjorë, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Gjykata, gjithashtu, është shprehur se parametrat kushtetues që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, duhet të përmbushen nga organet e administratës publike nëpërmjet zbatimit të dispozitave ligjore, konkretisht të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) (*shih vendimet nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 83, datë 26.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

87. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022 ka parashikuar në mënyrë të shprehur njoftimin e individit për vendimin e konfiskimit. Konkretisht, ajo ka parashikuar se autoriteti përgjegjës për ndjekjen e procedurës së konfiskimit të objektit, brenda 7 ditëve nga nxjerrja e urdhrit të ministrit përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore, i njofton masën e konfiskimit të objektit personave ose subjekteve që preken nga masa (*pika 13*). Në kushtet kur VKM-ja ka parashikuar njoftimin e masës së konfiskimit të objektit personave dhe subjekteve që preken nga masa, përfshirë, edhe siç pretendohet nga kërkuari, pronarët e tokës ose personat e tretë, të cilët mund të kenë lidhur kontrata për fitimin e pronësisë të njëjësive të ndërtimit dhe që janë lehtësisht të identifikueshëm nga regjistrat publikë, ky rregullim ligjor është i mjaftueshëm për t'u garantuar këtyre subjekteve të drejtat e tyre gjatë procedurës administrative të konfiskimit.

88. Nga ana tjetër, VKM-ja në fjalë nuk përjashton parashikimet e KPA-së në lidhje me procedurën e nxjerrjes së aktit administrativ, të cilat zbatohen edhe në rastin e procedurës së konfiskimit. Për më tepër, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 589/2022 nuk përmban ndonjë ndalim të shprehur në lidhje me të drejtën për të ankimuar masën e konfiskimit të objektit të ndërtuar pa leje



dhe subjektit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për ta kundërshtuar ose kërkuar pezullimin e saj, kur kjo masë është marrë në kundërshtim ose duke mos u respektuar legjislacioni në fuqi, duke i garantuar në këtë mënyrë elementet e procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në thelbin e vet e drejta e individit për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, nuk cenohet, ndaj ky pretendim i kërkuar është i pabazuar.

89. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa nuk është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë ajo duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë

10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.6.2023.

Shpallur më 10.7.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahim.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë